

# RAPORT

## VLERËSIM I SHPEJTË I NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK TË COVID-19 NË KOSOVË

Vala 2  
Janar 2021



# Përmbajtja

<b>1. Përmbledhje Ekzekutive</b>	<b>8</b>
<b>2. Hyrje</b>	<b>13</b>
2.1. Rreth Projektit	14
2.2. Metodologjia	15
<b>3. Gjetjet e anketës</b>	<b>20</b>
3.1. Anketa me ekonomi familjare	21
3.1.1 Profili i Familjeve dhe Karakteristikat Demografike	21
3.1.2 Vetëdijësimi dhe Informimi rreth COVID-19	26
3.1.3 Arsimi/Mësimi në distancë	35
3.1.4 Punësimi dhe burimet e jetesës	38
3.1.5 Ndarja e punëve të shtëpisë dhe dinamika shoqërore	66
3.1.6 Qasja në shërbime bazike dhe Siguria	71
3.1.7 Shëndeti seksual dhe riprodhues	84
3.2. Anketa me ndërmarrje	85
3.2.1 Profili i ndërmarrjeve	85
3.2.2 Ndikimi i COVID-19 në ndërmarrje	88
3.2.3 Pritjet për të ardhmen	113
<b>4. Përfundime</b>	<b>119</b>
4.1. Përfundime	120

## Lista e Figurave – Anketa e ekonomive familjare

Figura 1 Gjinia e të anketuarve.....	21
Figura 2 Moshë e të anketuarve .....	21
Figura 3 Shpërndarja rajonale e të anketuarve .....	21
Figura 4 Zona e banimit .....	21
Figura 5 Niveli i arsimit i të anketuarve .....	22
Figura 6 Etnia e të anketuarve .....	22
Figura 7 Statusi civil i të anketuarve .....	22
Figura 8 Përbërja e familjes.....	23
Figura 9 Të ardhurat e familjes në muaj .....	23
Figura 10 Ndryshimet në të ardhura për muaj që nga pandemia e COVID-19 .....	24
Figura 11 A kanë ndryshuar të ardhurat e familjes pas pandemisë COVID-19?, sipas të ardhurave aktuale të familjes.....	24
Figura 12 Numri i personave me nevoja të veçanta në familje.....	25
Figura 13 Burimet kryesore të informacionit dhe burimet më të besueshme të informacionit .....	26
Figura 14 Burimet kryesore të informacionit, sipas moshës.....	27
Figura 15 Burimet kryesore të informacionit, sipas gjinisë .....	28
Figura 16 Burimet kryesore të informacionit, sipas zonës së banimit .....	29
Figura 17 Burimet kryesore të informacionit, sipas nivelit të arsimit.....	30
Figura 18 Burimet më të besueshme të informacionit, sipas moshës .....	31
Figura 19 Niveli i pajtimit me deklaratën: "Informatat rreth COVID-19 më kanë ndihmuar ta mbroj veten dhe familjen nga virusi".....	31
Figura 20 Niveli i pajtimit me deklaratën: "Informatat rreth COVID-19 më kanë ndihmuar ta mbroj veten dhe familjen nga virusi".....	32
Figura 21 Niveli i pajtimit me deklaratën: "Njerëzit në komunitetin tim respektojnë masat parandaluese kundër COVID-19" .....	32
Figura 22 Gatishmëria për t'u vaksinuar për COVID-19, sipas moshës.....	33
Figura 23 Gatishmëria për t'u vaksinuar për COVID-19, sipas gjinisë.....	33
Figura 24 Gatishmëria për t'u vaksinuar për COVID-19, sipas rajonit .....	34
Figura 25 Gatishmëria për t'u vaksinuar për COVID-19, sipas përkatësisë etnike.....	34
Figura 26 Familjet me fëmijë të moshës shkollore .....	35
Figura 27 Ndjekja e mësimi fizikisht ose në distancë .....	35
Figura 28 Posedimi i pajisjeve të nevojshme teknike që fëmijët të jenë në gjendje të ndjekin mësimin në distancë .....	35
Figura 29 Posedimi i pajisjeve të nevojshme teknike që fëmijët të jenë në gjendje të ndjekin mësimin në distancë, sipas zonës së banimit.....	36
Figura 30 Posedimi i pajisjeve të nevojshme teknike që fëmijët të jenë në gjendje të ndjekin mësimin në distancë, sipas rajonit .....	37
Figura 31 Fëmijët në familje ishin në gjendje të ndiqnin rregullisht mësimin në distancë .....	37
Figura 32 Niveli i pajtimit me deklaratën "Cilësia e arsimit të ofruar përmes mësimve në distancë ishte e cilësisë së lartë".....	38
Figura 33 Statusi i punësimit para COVID-19, vala 1 vs. vala 2 .....	39
Figura 34 Statusi i punësimit para COVID-19, sipas gjinisë.....	40
Figura 35 Statusi i punësimit para COVID-19, sipas përkatësisë etnike .....	40
Figura 36 Sektori i punësimit para COVID-19, vala 1 vs. vala 2.....	41
Figura 37 Sektori i punësimit para COVID-19, sipas përkatësisë etnike.....	41
Figura 38 Sektori i punësimit para COVID-19, sipas rajonit .....	41
Figura 39 Sektori i punësimit para COVID-19, sipas gjinisë.....	41
Figura 40 Sektori i punësimit para COVID-19, sipas zonës së banimit .....	42

Figura 41	Sektori i punësimit para COVID-19, sipas moshës .....	42
Figura 42	Punësimi sipas aktivitetit të biznesit, sipas gjinisë.....	43
Figura 43	Ndryshimet në orët e kushtuara punës në krahasim me situatën para-COVID-19, vala 1 vs. vala 2 ...	44
Figura 44	Ndryshimet në orët e kushtuara punës në krahasim me situatën para-COVID-19, sipas gjinisë.....	44
Figura 45	Ndryshimet në orët e kushtuara punës në krahasim me situatën para-COVID-19, sipas gjinisë.....	45
Figura 46	Ndryshimet në orët e kushtuara punës në krahasim me situatën para-COVID-19, sipas sektorit të punësimit.....	45
Figura 47	Changes in hours devoted to work due to COVID-19 pandemic, by business activity .....	46
Figura 48	Detyrimi për marrjen e pushimit (leje) për shkak të pandemisë, sipas sektorit .....	47
Figura 49	Detyrimi për marrjen e pushimit (leje) për shkak të pandemisë, vala 1 vs. Vala 2.....	48
Figura 50	Detyrimi për marrjen e pushimit (leje) për shkak të pandemisë, sipas përkatësisë etnike .....	49
Figura 51	Detyrimi për marrjen e pushimit (leje) për shkak të pandemisë, sipas gjinisë.....	49
Figura 52	Ndryshimet në vendin (lokacionin) tipik të punës, vala 1 vs. Vala 2.....	50
Figura 53	Ndryshimet në vendin (lokacionin) tipik të punës, sipas gjinisë.....	50
Figura 54	Sfidat e punës në distancë.....	51
Figura 55	Sfidat e punës në distancë, sipas gjinisë .....	52
Figura 56	Preferenca në vazhdimin e punës nga shtëpia pas pandemisë.....	52
Figura 57	Preferenca në vazhdimin e punës nga shtëpia pas pandemisë, sipas gjinisë dhe statusit civil .....	53
Figura 58	Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas sektorit.....	53
Figura 59	Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas gjinisë.....	54
Figura 60	Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas përkatësisë etnike.....	54
Figura 61	Pagesa e kontributeve pensionale para COVID-19, sipas sektorit .....	55
Figura 62	Pagesa e kontributeve pensionale para COVID-19, sipas zonës së banimit.....	55
Figura 63	Pagesa e kontributeve pensionale para COVID-19, sipas përkatësisë etnike.....	55
Figura 64	Pagesa e kontributeve pensionale para COVID-19, sipas gjinisë.....	56
Figura 65	Niveli i pajtimit me deklaratën "Punëdhënësi im ka marrë masa parandaluese për të ndaluar përhapjen e COVID-19 në vendin tim të punës" .....	56
Figura 66	Punësimi aktual, sipas statusit të punësimit para përhapjes së COVID-19.....	57
Figura 67	Sektori aktual i punësimit.....	57
Figura 68	Punësimi aktual sipas aktivitetit të biznesit .....	58
Figura 69	Të anketuarit që janë fituesit kryesorë të të ardhurave.....	59
Figura 70	Të anketuarit që janë fituesit kryesorë të të ardhurave, sipas gjinisë .....	59
Figura 71	Punësimi sipas aktivitetit të biznesit i fituesit kryesor të të ardhurave .....	60
Figura 72	Ndikimi në orët e paguara të punës të fituesit kryesor të të ardhurave të familjes nga COVID-19 .....	60
Figura 73	Ndikimi në orët e paguara të punës nga COVID-19, sipas gjinisë .....	61
Figura 74	Efektet e COVID-19 në burimet personale të të ardhurave.....	61
Figura 75	Efektet e COVID-19 në burimet personale të të ardhurave, vala 1 vs. vala 2.....	62
Figura 76	Të anketuarit që morën përfitime nga papunësia dhe/ose ndonjë mbështetje financiare që nga përhapja e COVID-19.....	63
Figura 77	Të anketuarit që kanë marrë mbështetje në të mira materiale që nga përhapja e COVID-19.....	63
Figura 78	Kompensimet e ndërmarra për humbjen e të ardhurave/humbjen e mundshme të të ardhurave nga familjet që nga fillimi i COVID-19 .....	64
Figura 79	Qasja në shëndet dhe zvogëlimi i shpenzimeve shëndetësore.....	65
Figura 80	Ndryshimet në orët e kushtuara aktiviteteve si rezultat i COVID-19.....	66
Figura 81	Ndryshimet në orët e kushtuara aktiviteteve si rezultat i COVID-19, vala 1 vs. vala 2 (1/2).....	67
Figura 82	Ndryshimet në orët e kushtuara aktiviteteve si rezultat i COVID-19, vala 1 vs. vala 2 (2/2) .....	68
Figura 83	Ndryshimet në orët e kushtuara aktiviteteve si rezultat i COVID-19, sipas gjinisë (1/2).....	69
Figura 84	Ndryshimet në orët e kushtuara aktiviteteve si rezultat i COVID-19, sipas gjinisë (2/2).....	70
Figura 85	Efektet e COVID-19 në rolet dhe përgjegjësitë brenda familjes, sipas gjinisë.....	71
Figura 86	Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ju personalisht ndonjërin nga të mëposhtmet?, vala 1 vs. vala 2 .....	72

Figura 87 Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ju personalisht ndonjë të mëposhtme?, sipas gjinisë.	73
Figura 88 Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ju personalisht ndonjë të mëposhtme?, sipas moshës (1/2) .....	74
Figura 89 Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ju personalisht ndonjë të mëposhtme?, sipas moshës (2/2) .....	74
Figura 90 Të anketuarit që humbën vendet e punës dhe deklaruan shëndetin mendor dhe emocional të prekur .....	75
Figura 91 Përvoja personale me vështirësi në qasjen në shërbime bazike, vala 1 vs. vala 2 .....	75
Figura 92 Përvoja personale me vështirësi në qasjen në shërbime bazike, sipas gjinisë.....	76
Figura 93 Përvoja personale me vështirësi në qasjen në shërbime bazike, sipas rajonit .....	77
Figura 94 Përvoja personale me vështirësi në qasjen në shërbime bazike, sipas zonës së banimit.....	78
Figura 95 Experienced personally requests for favors or bribes for accessing basic services .....	79
Figura 96 Perceptimi për rritjen e dhunës në familje që nga përhapja e COVID-19, vala 1 vs. vala 2 .....	80
Figura 97 Perceptimi për rritjen e dhunës në familje që nga përhapja e COVID-19, sipas rajonit.....	81
Figura 98 Perceptimi për rritjen e dhunës në familje që nga përhapja e COVID-19, sipas zonës së banimit, gjinisë dhe përkatësisë etnike.....	81
Figura 99 Njohuri se ku mund të kërkohet ndihmë dhe mbështetje në rast se dikush përjeton dhunë në familje të tilla si linja telefonike, mbështetje psikologjike dhe policore, vala 1 vs. vala 2 .....	82
Figura 100 Njohuri se ku mund të kërkohet ndihmë dhe mbështetje në rast se dikush përjeton dhunë në familje të tilla si linja telefonike, mbështetje psikologjike dhe policore, sipas zonës së banimit, gjinisë dhe përkatësisë etnike.....	83
Figura 101 Që nga përhapja e COVID19, a keni përjetuar personalisht vështirësi në qasjen në shërbimet e mëposhtme të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe kontrceptiv për vetveten, partnerin tuaj ose anëtar tjetër të familjes? .....	84

### Lista e Figurave – Anketa me ndërmarrje

Figura 102. Shpërndarja rajonale e ndërmarrjeve.....	86
Figura 103. Madhësia e ndërmarrjes .....	86
Figura 104. Statusi ligjor i ndërmarrjeve.....	86
Figura 105. Vitet në treg.....	86
Figura 106. Ndarja e ndërmarrjeve sipas sektorit .....	87
Figura 107. Ndërmarrjet eksportuese .....	87
Figura 108 Gjinia e pronarëve të kompanisë .....	88
Figura 109. Performanca financiare e ndërmarrjeve para COVID-19.....	89
Figura 110 Burimet kryesore të informacionit në lidhje me COVID-19 (rreziqet, veprimet parandaluese të rekomanduara, strategjitë e përballimit), vala 1 vs. vala 2 .....	90
Figura 111 Mbështetja për masat aktuale të qeverisë për të mbyllur/kufizuar veprimtarinë e bizneseve në mënyrë që të ngadalësohet përhapja e COVID-19, vala 1 vs. vala 2 .....	91
Figura 112. Niveli i mbështetjes për masat aktuale të qeverisë për të mbyllur/kufizuar veprimtarinë e bizneseve në mënyrë që të ngadalësohet përhapja e COVID-19, sipas madhësisë së ndërmarrjes .....	92
Figura 113 Ndikimi i COVID-19 në biznese në përgjithësi, vala 1 vs. vala 2.....	92
Figura 114 Ndikimi i COVID-19 në biznese në përgjithësi, sipas madhësisë së ndërmarrjes .....	93
Figura 115 Arsyet e ndikimit shumë negativ dhe negativ, sipas madhësisë së biznesit.....	94
Figura 116 Arsyet kryesore për pezullimin e aktivitetit të biznesit, vala 1 vs. vala 2.....	95
Figura 117 Arsyet kryesore për pezullimin e aktivitetit të biznesit, sipas madhësisë së ndërmarrjes.....	96
Figura 118 Zbatueshmëria e deklaratave në lidhje me periudhën maj - shtator 2020.....	97
Figura 119 Ndalja e plotë ose e pjesshme e aktivitetit të biznesit për shkak të COVID-19, vala 1 vs. vala 2 .....	98
Figura 120 Arsyet dhe arsyeja kryesore për mbylljen e plotë të aktivitetit.....	99
Figura 121 Perceptimi nëse pakot e ardhshme të lehtësimeve ekonomike për bizneset do të shpërndahen në mënyrë të drejtë, sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe rajonit .....	100

Figura 122 Perceptimi nëse do të tentohet mashtrimi dhe korrupsioni në lidhje me pakot e ndihmave për bizneset, sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe rajonit .....	101
Figura 123 Ndërmarrjet që vazhdojnë të paguajnë kontribute pensioni për punonjësit e tyre si më parë COVID-19, vala 1 vs. vala 2 .....	102
Figura 124. Ndërmarrjet që vazhdojnë të paguajnë kontribute pensioni për punonjësit e tyre si më parë COVID-19, sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe viteve në treg .....	102
Figura 125. Punonjësit që kanë dhënë dorëheqjen nga puna e tyre .....	103
Figura 126. Ndryshimi në vendin e punës për shkak të COVID-19, vala 1 vs. vala 2 .....	103
Figura 127. Problemet për bizneset duke pasur parasysh situatën aktuale me COVID-19, vala 1 vs. vala 2.....	104
Figura 128. Problemet e tanishme vs. shqetësimi kryesor nëse COVID-19 vazhdon të përhapet gjatë dy-tre muajve të ardhshëm, vala 1 vs vala 2 .....	105
Figura 129. Masat e ndërmarra nga ndërmarrjet për punonjësit, vala 1 vs. vala 2 .....	106
Figura 130 Masat e ndërmarra nga ndërmarrjet për punonjësit, sipas madhësisë së ndërmarrjes .....	107
Figura 131. Ndikimet në të ardhura, shpenzime, shitje dhe inventar .....	107
Figura 132 Ndikimet në të ardhura, shpenzime, shitje dhe inventar, sipas madhësisë së ndërmarrjes .....	108
Figura 133 Ndikimet në të ardhura, shpenzime, shitje dhe inventar, sipas aktivitetit të biznesit .....	109
Figura 134 Ndërmarrjet që përdorin tregtinë elektronike (e-tregtinë) .....	110
Figura 135. Konsiderimi i ndërmarrjeve për të marrë një kredi për t'u përballur me efektet aktuale të situatës COVID-19, vala 1 vs. vala 2 dhe sipas madhësisë së ndërmarrjes .....	111
Figura 136. Arsyeya kryesore e mos konsiderimit të marrjes së një kredie, vala 1 vs vala 2.....	112
Figura 137 Arsyeya kryesore e mos konsiderimit të marrjes së një kredie, sipas madhësisë së ndërmarrjes .....	112
Figura 138. Duke marrë parasysh të gjitha, edhe për sa kohë mund të përballojnë bizneset situatën aktuale, vala 1 vs vala 2 .....	113
Figura 139. Sugjerime për institucionet e Kosovës mbi masat që mund të ndihmojnë bizneset për t'u përballur me situatën.....	114
Figura 140. Sugjerime për organizatat ndërkombëtare mbi masat që mund të ndihmojnë bizneset për t'u përballur me situatën, sipas madhësisë së ndërmarrjes .....	115
Figura 141. Bizneset që kishin plane investimi para situatës COVID-19, sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe viteve në treg .....	116
Figura 142. Ndryshimi i planeve për të investuar për shkak të COVID-19, vala 1 vs. vala 2 .....	116
Figura 143. Bizneset që gjetën mundësi të reja në lidhje me COVID-19, vala 1 vs. vala 2 .....	117
Figura 144. Perceptimi i bizneseve se kur Kosova do të kthehet në jetën normale, vala 1 vs. vala 2 .....	117
Figura 145 Perceptimi i bizneseve se kur Kosova do të kthehet në jetën normale, sipas gjinisë së pronarëve të kompanisë.....	118

## Lista e Tabelave

### Anketa me Ekonomi Familjare

Tabela 1. Shpërndarja e mostrës sipas rajonit.....	16
Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas zonës së banimit.....	16
Tabela 3. Shpërndarja e mostrës sipas gjinisë .....	16
Tabela 4. Shpërndarja e mostrës sipas moshës.....	16
Tabela 5. Shpërndarja e mostrës sipas statusit të punësimit .....	17

### Anketa me ndërmarrje

Tabela 6. Shpërndarja e ndërmarrjeve në Kosovë.....	18
Tabela 8 Numri i stafit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme para dhe pas COVID-19, mesatarja (mesatarja e shkurtuar) .....	105

## Deklaratë për mos pranimin e përgjegjësisë

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të të anketuarve që morën pjesë në Anketën me Ekonomi Familjare si dhe në Anketën me Ndërmarrje në Kosovë, dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP, UNFPA ose UN Women.

Autore: Laura Petrak, Nora Jusufi

Prishtinë  
Janar 2021

# 1. Përmbledhje

## Ekzekutive



Që nga marsi i vitit 2020, Kosova<sup>1</sup> po përballet me implikimet shumë-dimensionale të pandemisë COVID-19. Pandemia ka ndikuar dhe ende po ndikon në një mënyrë domethënëse në ekonominë familjare dhe ndërmarrjet në Kosovë, duke përfshirë jetën dhe aktivitetet e përditshme të njerëzve, shëndetin fizik dhe mendor, si dhe në të ardhurat e familjeve dhe funksionimin e ndërmarrjeve.

Nëntë muajt e kaluar janë shënuar me faza të ndryshme të masave kufizuese për të ngadalësuar përhapjen e virusit në Kosovë. Pasi kaloi një periudhë të rreptë bllokimi në pranverë, e cila përfshinte mbylljen e kufijve tokësorë, ndaljen e aktiviteteve të ndërmarrjeve dhe kufizimin e lëvizjes së njerëzve, Kosova filloi të hapet gradualisht përsëri në qershor 2020. Që atëherë, goditje të ndryshme të rasteve me COVID-19 çuan në rivendosjen e masave në të gjithë Kosovën duke ndikuar tek njerëzit dhe tek ekonomia e Kosovës. Si kudo tjetër në Evropë, që nga tetori 2020, situata është përkeqësuar ndjeshëm përsëri me një numër të lartë të infeksioneve të reja dhe vdekjeve për shkak të COVID-19. Numri i përgjithshëm i regjistruar i infeksioneve në Kosovë, deri në fund të dhjetorit, ishte 49,306 nga 173,986 teste dhe ka gjithsej 1,161 vdekje si pasojë e virusit.<sup>2</sup>

Në maj të vitit 2020, UNDP, UN Women dhe UNFPA realizuan Vlerësimin e parë të Ndikimit Socio-Ekonomik (VNSE) të pandemisë në Kosovë dhe të masave institucionale përkatëse. Qëllimi i këtij vlerësimi është të shqyrtojë ndikimin e pandemisë COVID-19 mbi familjet dhe ndërmarrjet dhe të kuptojë se në cilat fusha (individë, amvisëri dhe ndërmarrje) agjencitë e angazhuara, institucionet e Kosovës dhe palët e tjera të interesit duhet të përqendrojnë ndihmën e tyre. Duke marrë parasysh efektet shumë-dimensionale të pandemisë COVID-19, u konsiderua jetike të vazhdohet dhe të përsëritet mbledhja e të dhënave me dy valë shtesë të vlerësimit. Qëllimi këtu është të krijojmë të dhëna të krahasueshme me kalimin e kohës dhe të mundësojmë një kuptim gjithëpërfshirës të efekteve të krizës në Kosovë. Ky raport paraqet dhe analizon gjetjet e valës së dytë të vlerësimit të ndikimit socio-ekonomik të kryer në nëntor 2020 dhe bën krahasime me gjetjet e të dhënave të valës së parë të kryer në maj 2020, aty ku është e zbatueshme.

Gjatë valës së dytë të vlerësimit, mostra e ndërmarrjeve u rrit trefish (nga 202 në 601). Kjo mundësoi analizë më të saktë dhe precize të të dhënave. Për më tepër, një numër pyetjesh të reja janë shtuar në pyetësorët e anketës në mënyrë që të trajtohen temat që janë bërë të rëndësishme gjatë muajve të fundit.

Anketa e re e ekonomive familjare gjithashtu përfshin pyetje në lidhje me gatishmërinë e njerëzve për t'u vaksinuar nëse iu ofrohet mundësia. Për më tepër, ajo përfshin edhe një grup të pyetjeve të reja në lidhje me punësimin që nga shpërthimi i pandemisë COVID-19 për të vlerësuar si sfidat, ashtu edhe mundësitë, nëse ka, për të punuar në këtë periudhë. Për më tepër, pyetje mbi preferencën e të punuarit në vend fizik ose online (në internet) u shtuan gjithashtu.

Anketa me ekonomi familjare u krye me 1,425 të anketuar nga 11 nëntori 2020 deri më 27 nëntor 2020. Anketa me ndërmarrje u krye me 601 ndërmarrje nga 13 nëntori 2020 deri më 30 nëntor 2020.

Media tradicionale u konsiderua si burimi më i besuar dhe i përdorur më shpesh në marrjen e informacionit për COVID-19 për qytetarët e Kosovës në lidhje me rreziqet, veprimet parandaluese të rekomanduara dhe strategjitë e përballimit. Ngjashëm me rezultatet e valës 1 të vlerësimit, të anketuarit u mbështetën kryesisht në radio, televizion dhe gazeta (89%) si një burim kryesor i informacionit për COVID-19. Këto burime u konsideruan gjithashtu si më të besueshmet (78%). Interneti dhe rrjetet sociale u përmendën nga pothuajse tre në katër të anketuar si burimi kryesor i informacionit në lidhje me COVID-19 (73%), megjithatë, vetëm 39% u besuan atyre. Për ndërmarrjet, interneti dhe rrjetet sociale mbetën burimet më të përdorura të informacionit sipas rreth dy të tretave të të anketuarve nga ndërmarrjet (67%). Gjatë valës 2, më pak të

<sup>1</sup> Referencat për Kosovën duhet të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999)

<sup>2</sup> IKSHPK. Njoftimi ditor për COVID-19. <https://www.facebook.com/IKSHPK/photos/a.527771290684213/3354325781362069/> Qasur më 22.12.2020

anketuar nga ndërmarrjet deklaruan se kanë përdorur radio, televizion dhe gazeta (25%) krahasuar me valën 1 (33%).

Në mënyrë që të frenohet përhapja e COVID-19, masa të ndryshme janë vendosur në Kosovë. Të dhënat tregojnë se shumica e të anketuarve mendonin se komuniteti i tyre i respekton masat parandaluese të vendosura (3.8 nga 5.0 pikë<sup>3</sup>), por në të njëjtën kohë treguan **një nivel të lartë rezervimi ndaj një vaksine të mundshme**. Rreth 44% e të gjithë të anketuarve deklaruan se ata ose nuk do ta konsideronin marrjen e vaksinës (24%) ose se anonin nga mos vaksinimi (20%). Të anketuarit që ishin 65 vjeç ose më të vjetër ishin grupmosha që anonin drejt marrjes së vaksinës ose që patjetër do ta merrnin vaksinën (51%). Ndërsa 31% e të anketuarve që ishin 25-34 vjeç do ta bënin të njëjtën gjë.

Në shtator të vitit 2020, pas gjashtë muajve të masave kufizuese, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) hapi shkollat bazuar në dy skenarë: disa klasa do të ndiqnin shkollën fizikisht në tërë Kosovën, disa do t'i ndiqnin ato në bazë të rotacionit, si online (në internet) ashtu edhe fizikisht, varësisht nga situata në nivel komunal<sup>4</sup>. Rezultatet e anketës gjithashtu zbuluan se gati tre në katër fëmijë po **vijonin fizikisht shkollën** në kohën e intervistës në nëntor 2020 (72%). Rreth 20% e fëmijëve ishin pjesë e një sistemi rotacioni dhe ndoqën shkollën fizikisht në disa ditë, ndërsa mësuan në distancë në të tjerat. Vetëm 8% e fëmijëve mësuan tërësisht nga distanca në nëntor 2020, nga këta, vetëm në tetë raste (15%), fëmijët që mësonin nga distanca nuk ishin në gjendje të ndiqnin rregullisht mësimin në distancë.

Para pandemisë, 65% e burrave dhe 31% e grave ishin të punësuar. Gjysma e të gjithë të anketuarve deklaruan në nëntor 2020 se nuk kishin përjetuar ndryshime në orët e tyre të punës (50%) pas fillimit të pandemisë, krahasuar me valën 1 të vlerësimit, ku vetëm 22% nuk raportuan asnjë ndryshim në orët e punës. Një në pesë të anketuar përjetuan **ulje të orëve të punës** pa e humbur punën (20%), ndërsa 11% raportuan se e humbën punën e tyre (krahasuar me 8% që raportuan **humbjen e punës** gjatë valës 1 të vlerësimit). Shumica e atyre që përjetuan humbje të punës, nuk morën mbështetje financiare ose përfitime të papunësisë nga institucionet qendrore (81%) apo komunat (91%). Duhet të theksohet gjithashtu se shumica dërrmuese (89%) e atyre që kërkuan punësim para COVID-19 mbetën të papunë edhe në nëntor 2020.

Vlerësimet gjithashtu matën **ndikimin që COVID-19 ka pasur në ndërmarrje** deri tash. Të dhënat tregojnë qartë se ndikimet negative janë rritur me kalimin e kohës. Në maj të vitit 2020, rreth 23% e ndërmarrjeve deklaruan që ndikimi i pandemisë ishte shumë negativ. Ky numër u rrit në 55% në nëntor 2020, me një rritje prej 32 pikë përqindjeje (pp). Mungesa e klientëve (89%), vështirësitë në pagesat e pagave (39%) dhe vështirësitë për të përmbushur detyrimet tatimore (33%) u dalluan si tri sfidat kryesore për ndërmarrjet në nëntor 2020.

Sidoqoftë, zbutja e masave kufizuese dhe rihapja graduale e Kosovës në qershor 2020 ishin të dukshme në të dhënat e marra nga vala e dytë e anketës. Gjatë valës 1, mbi gjysma e të anketuarve raportuan se **aktivitetet e tyre të ndërmarrjeve ishin ndaluar plotësisht** për shkak të situatës me COVID-19 (56%), ndërsa në nëntor 2020, vetëm 13% raportuan të njëjtën gjë. Në të kundërt, ndalimet e pjesshme të aktiviteteve të ndërmarrjeve u raportuan më shumë gjatë valës 2 (40%) sesa gjatë valës 1 (31%).

Ndërmarrjet të cilat u desh të **ndalojnë pjesërisht aktivitetet** e tyre përmendën më së shpeshti masat kufizuese (44%, një ulje prej 37 pp krahasuar me valën 1) ose mungesën e klientëve dhe kërkesës (25%, një rritje prej 14 pp në krahasim me valën 1) si arsyt kryesore. Vetëm 28% e atyre që ndaluan plotësisht ose pjesërisht aktivitetet e tyre paguan rroga të plota për punonjësit e tyre. Ato ndërmarrje që u desh të **ndalonin plotësisht aktivitetet** e tyre kryesisht e bënë këtë për shkak të mungesës së klientëve (70%).

<sup>3</sup>. Matur në një shkallë nga 0,0 deri në 5,0 pikë, ku një është nuk pajtohem aspak dhe pesë është pajtohem plotësisht

<sup>4</sup> Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Vendim për fillimin e mësimin në vitin e ri shkollor 2020/2021 në kushtet pandemike.

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/09/vendimi-me-nr-01-b-1280-per-fillimin-e-mesimit-ne-vitin-e-ri-shkollor-2020-2021-ne-kushte-pandemie.pdf>. Qasur më: 22.12.2020

Megjithatë, **mbështetja e ndërmarrjeve drejt masave kufizuese** për të mbyllur ose kufizuar aktivitetin e ndërmarrjeve ka rënë ndjeshëm. Në maj të vitit 2020, mbi gjysma e të anketuarve të ndërmarrjeve deklaruan se mbështesin deri diku (44%) ose mbështesin fuqimisht (16%) masat kufizuese. Në nëntor 2020, vetëm 21% i mbështetën deri diku dhe 6% i mbështetën fuqimisht këto masa. Kundërshtimi i fortë ndaj masave të përmendura u rrit për 30 pp nga 8% në maj në 38% në nëntor 2020.

Të anketuarit e ekonomive familjare që mbetën të punësuar gjatë pandemisë më së shpeshti **punuan në ambientet e tyre të punës** (89%). Vetëm 3% kanë punuar me kohë të plotë nga shtëpia në nëntor 2020, në krahasim me 27% në maj 2020. Tre në katër të anketuar nga ata **që punonin në distancë** raportuan rritjen e konsiderueshme të ngarkesës me punë dhe faktin që duhej të bënin shumë detyra përnjëherë si sfida (përkatesisht 60% dhe 58%). Kur u pyetën nëse do të **preferonin të vazhdonin të punonin nga shtëpia** pas pandemisë, përgjigjet ndryshonin me 34% që nuk dinin përgjigje, 35% nuk preferonin të vazhdonin punën në distancë dhe 31% preferonin të vazhdonin të punonin nga shtëpia. Për më tepër, gjetjet nga anketa me ndërmarrje nënvizuan rezultatet e anketës me familje në lidhje me këtë çështje; shumica e ndërmarrjeve të anketuara deklaruan se në kohën e intervistës **të gjithë punonjësit punonin në ambientet e ndërmarrjes** (91%), në krahasim me disa që punonin nga shtëpia (6%) ose të gjithë punonin nga shtëpia (3%).

Anketa gjithashtu vlerësoi **efektet e COVID-19 në të ardhurat personale dhe familjare**. Një në katër raportoi rënie në orët kushtuar punës me pagë së fituesit kryesor të të ardhurave të familjes (25%) dhe 43% deklaruan se të ardhurat e përbashkëta familjare ishin ulur (49% e familjeve raportuan një rënie gjatë valës 1). Shumica e familjeve nuk kanë marrë ndonjë mbështetje në të mira materiale (të tilla si ushqime, pajisje për higjienë personale ose familjare ose pajisje personale mbrojtëse) nga institucionet qendrore (99%), komunat (96%), ose OJQ-të dhe Organizatat Ndërkombëtare (97%). Gati tri në katër familje zvogëluan shpenzimet e tyre për aktivitete të kohës së lirë dhe mallra jo-thelbësore për të kompensuar humbjen, ose një humbje të mundshme të të ardhurave (70%), ndërsa pothuajse gjysma i shfrytëzuan kursimet e tyre (49%).

Ndërmarrjet po ashtu vuajtën nga ndikimi negativ financiar i COVID-19 për sa i përket të ardhurave dhe shpenzimeve. Më shumë se tetë në 10 ndërmarrje raportuan një rënie në shitjet e produkteve ose shërbimeve, si dhe në të ardhura (88% secila). Në anën tjetër, shpenzimet e përgjithshme dhe të punës u rritën për një numër të konsiderueshëm të ndërmarrjeve (përkatesisht 44% dhe 19%). Rreth 43% e të gjitha ndërmarrjeve që morën pjesë në këtë vlerësim deklaruan se kishin **plane për investime** përpara pandemisë COVID-19. Nga këto, më shumë se tre në katër të anketuar thanë se kishin vendosur të shmangin bërjen e

COVID-19 gjithashtu ka ndikuar në një varg **dinamikash sociale** për familjet në Kosovë. Një rritje e orëve kushtuar **mbështetjes emocionale për anëtarët e rritur të familjes** u dallua me pjesën dërrmuese të të anketuarve të cilët përmendën një rritje në lidhje me këtë veprim (37%). Të dhënat zbuluan se gratë kishin më shumë gjasa të kishin kaluar më shumë kohë në pastrim (24%) dhe gatim (18%) krahasuar me burrat (përkatesisht 13% dhe 6%). Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i burrave deklaruan se ata zakonisht nuk merreshin me gatim (58%) ose pastrim (35%) fare. Ndërsa më shumë se një në tre burra raportuan se partnerja e tyre ndihmoi më shumë **në punët e shtëpisë** që nga fillimi i pandemisë (63%), vetëm 36% e grave raportuan të njëjtën gjë.

Rezultatet krahasuese të të dhënave midis valës 1 dhe valës 2 tregojnë qartë se **efektet psikologjike të shkaktuara nga situata COVID-19 janë rritur**. Mbi një e treta (36%) deklaruan se shëndeti i tyre mendor ose emocional është prekur, krahasuar me 28% që deklaruan të njëjtën gjë në maj 2020. Më shumë gra kanë përjetuar efekte negative në shëndetin e tyre mendor (40%) sesa burrat (32%). Rastet e sëmundjes fizike dhe sëmundjes së një anëtarit të familjes gjithashtu janë rritur me 9 pp (nga 2% në 11%) dhe 11 pp (nga 5% në 16%), përkatesisht.

Vështirësitë që kanë të bëjnë me **qasjen e shërbimeve themelore, shërbimeve sociale dhe shëndetësore, transportit publik dhe produkteve themelore shëndetësore** u ulën ndjeshëm kur krahasohen rezultatet mes valës 1 dhe 2. Megjithatë, disa vështirësi duket se kanë vazhduar. Për shembull, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve raportuan disa ose vështirësi të mëdha në lidhje me qasjen në produktet ushqimore (26%), pajisjet personale mbrojtëse (PPM; 24%) dhe shërbimet shëndetësore (24%).

Një rritje e **dhunës në familje** që nga shpërthimi i pandemisë COVID-19 është vërejtur në shumë vende të botës. Kohët e fundit, Policia e Kosovës publikoi të dhëna për rastet e dhunës në familje të raportuara ndërmjet janarit dhe shtatorit 2020. Numri i rasteve arriti në 1,571, rreth 144 raste më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019.<sup>5</sup> Perceptimi i rritjes së dhunës në familje është gjithashtu qartë i dukshëm në rezultatet e anketës të familjeve. Rreth 59% e të anketuarve që morën pjesë në valën e dytë të vlerësimit menduan se dhuna në familje ishte rritur që nga fillimi i pandemisë. Kjo paraqet një rritje të lehtë me 3 pp krahasuar me majin 2020. Është shqetësuese se përdherisa 63% e grave besonin se dhuna në familje ishte rritur, gati një në tre prej tyre deklaroi se nuk dinte se ku të **kërkonte ndihmë dhe mbështetje** në rast të përjetimit të dhunës në familje (32%).

Anketa me ndërmarrje gjithashtu përfshiu pyetje që kishin të bënin me **pritjet për të ardhmen** e ndërmarrjeve. Duke nënvizuar pasigurinë e përgjithshme që është e pranishme në të gjithë botën, më shumë se një e treta e të anketuarve të biznesit nuk kishin një përgjigje kur u pyetën se sa më gjatë biznesi i tyre mund të përballonte situatën pandemike (36%). Gjatë valës 1 kjo përqindje arriti në 13%. Pothuajse po aq parashikuan që bizneset e tyre mund të përballonin situatën vetëm për rreth 1-2 muaj më shumë (35%).

Kur u pyetën në lidhje me **sugjerimet për institucionet** e Kosovës mbi masat që mund të ndihmojnë ndërmarrjet e të anketuarve, rreth gjysma përmendën se miratimi i ligjit për rimëkëmbje ekonomike (51%) do t'i ndihmonte.<sup>6</sup> Gati gjysma nuk kishin ndonjë **sugjerim për organizatat ndërkombëtare** mbi masat që mund të ndihmonin ndërmarrjet e tyre (44%). Mirëpo, një në tre të anketuar të ndërmarrjeve sugjeruan që mbështetja financiare përmes pakove ekonomike nga organizatat ndërkombëtare do të ndihmonte (33%). Në lidhje me këtë, është e rëndësishme të theksohet se mbi gjysma e ndërmarrjeve besuan se do të kishte mashtrim dhe korrupsion në lidhje me pakot e ndihmave për ndërmarrje (55%). Dy në pesë të anketuar nga ndërmarrjet besuan se do të duhen më shumë se gjashtë muaj derisa jeta në Kosovë të kthehet në normalitet (40%, rritje prej 13 pp krahasuar me valën 1).

---

<sup>5</sup> Balkan Insight, Nëntor 2020, <https://balkaninsight.com/2020/11/25/women-of-southeast-central-europe-protest-rise-in-male-violence/> Qasur më 08.12.2020

Policia e Kosovës. Përgjigje me email ndaj kërkesës zyrtare nga IDRA.

<sup>6</sup> Pas shtatë përpjekjeve të dështuara, miratimi i ligjit për rimëkëmbjen ekonomike u bë në dhjetor 2020, Balkan Insight: <https://prishtinainsight.com/economic-recovery-package-passes-at-kosovo-assembly/> Qasur më 10.12.2020

Kuvendi miratoi Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19, Kuvendi i Kosovës

<http://www.kuvendikosoves.org/shq/ajmi/kuvendi-miratoi-projektligjin-per-rimekembjen-26325/#> Qasur më: 19.12.2020

## 2. Hyrje

## 2.1. Rreth Projektit

Që nga shfaqja e COVID-19 në Kosovë, njerëzit dhe ekonomia e saj u desh të përballeshin dhe ballafaqoheshin me implikime të ndryshme të shkaktuara nga pandemia. Ngjashëm me vendet e tjera, në mars 2020 u vendosën masa të rrepta kufizuese për të frenuar përhapjen e virusit. Këto masa vënë një ngarkesë mbi njerëzit dhe ndërmarrjet në tërë Kosovën, ndërsa institucionet qendrore dhe ato të kujdesit shëndetësor bënë përpjekje të mëdha për të trajtuar situatën e re.

Një "kthim i menjëherë në normalitet" u vendos në maj të vitit 2020, përmes një plani hap pas hapi për të hequr gradualisht masat kufizuese dhe për të rihapur shoqërinë në një mënyrë të sigurt. Gjatë qershorit 2020, shumica e kufizimeve ishin hequr, ndërsa rregullat si distanca fizike dhe ndalimet e grumbullimit masiv mbetën në fuqi. Megjithatë, deri në korrik të vitit 2020, një rritje e numrit të rasteve u bë e qartë dhe çoi në futjen e masave të reja, duke përfshirë orë policore gjatë natës dhe mbajtje të detyrueshme të maskës në hapësira të brendshme dhe të jashtme publike, ndër të tjera. Në shtator 2020, u mor vendimi për të rihapur shkollat dhe për të vazhduar mësimin në shkollë. Situata në objektet arsimore po monitorohet dhe mund të rezultojë në ndryshime të rregullave përsëri nëse shfaqen grumbull rastesh. Gjatë tetorit të vitit 2020, situata filloi të përkeqësohej ndjeshëm, me rritjen e numrit të infeksioneve dhe vdekjeve të reja mes atyre që kishin marrë virusin. Kjo bëri që në muajin vijues të vendosen masat e reja të tilla si orë policore për komunat me numër të madh të rasteve, si dhe për grupet e rrezikut, kufizimet në lidhje me sportet e brendshme dhe aktivitetet kulturore, ndalimin e tubimeve të më shumë se pesë personave, transportin publik që operon me gjysmë kapaciteti, dhe uljen e orëve të punës për ndërmarrjet e tregtisë me pakicë dhe atyre kulinare.

Institucionet e Kosovës kanë bërë përpjekje të ndryshme për të mbështetur ekonominë familjare dhe ndërmarrjet; akterët ndërkombëtarë dhe vendet e tjera gjithashtu kanë bërë përpjekje për të mbështetur Kosovën. Sidoqoftë, shkatërrimi social dhe ekonomik është i rëndë, duke prekur njësoj njerëzit dhe ekonominë. Pandemia COVID-19 ka pasur ndikime shumë-dimensionale në Kosovë dhe njerëzit e saj, duke përfshirë implikime të mëdha socio-ekonomike. Efektet janë tashmë të dukshme dhe gjithashtu parashikohet të vazhdojnë të ndryshojnë nga rritja e papunësisë, varfëria e përkeqësuar, humbja e të ardhurave, pasiguria në punë, rritja e pabarazive, ngecjet në arsim dhe kthimi mbrapsht në përparimin e hendekut gjinor.

Në maj të vitit 2020, UNDP, UN Women dhe UNFPA bashkëpunuan për të kryer një Vlerësim të Shpejtë të Ndikimit Social-Ekonomik (SEIA) të pandemisë dhe masave institucionale përkatëse në (1) shëndetin, mirëqenien financiare dhe emocionale të njerëzve, si dhe grupet e cenueshme të prekura dhe në (2) performancën ekonomike të sektorit privat dhe implikimet përkatëse për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Qëllimi i përgjithshëm i vlerësimit ishte të mblidhte informacion të besueshëm që mundëson një kuptim më të mirë të efekteve të COVID-19 dhe të sigurojë dëshmi për politik bërësit, studiuesit dhe partnerët e zhvillimit që të jenë në gjendje të planifikojnë më mirë përgjigjet përmes politikave dhe programeve.

Ndërsa kriza vazhdon, Ekipi i UN Kosova vendosi të vazhdojë vlerësimin e ndikimit përmes kryerjes së dy valëve të tjera të SEIA, të bazuara në mënyrë rigorozë në metodologjinë dhe standardizimin e SEIA-s së parë. Qëllimi prandaj është të prodhojmë të dhëna të krahasueshme me kalimin e kohës dhe të mundësojmë një kuptim të përditësuar të efekteve të krizës.

Rezultatet e dy valëve shtesë të vlerësimeve do të ndihmojnë në përcaktimin e mëtejshëm të natyrës dhe shtrirjes së ndikimit sistematik të krizës COVID-19, përcaktojnë qëllimin, intensitetin dhe kërcënimin e saj për grupet e cenueshme dhe ekonominë lokale në Kosovë.

1. Vlerësim të shpejtë të ndikimit socio-ekonomik të krizës në familjet kosovare
2. Vlerësim të ndikimit afatshkurtër në performancën e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, humbjet e mundësive biznesore dhe nevojat e rimëkëmbjes së ndërmarrjeve.

Vlerësimi është i shpejtë në realizim për të mundësuar hartimin dhe vendosjen e masave reaguese për të zvogëluar ndikimin negativ për familjet dhe ndërmarrjet. Gjetjet e hulumtimit mundësojnë që të kuptohet më mirë se kush u ndikua më tepër, llojin e burimeve të nevojshme, si dhe fokusimin në boshllëqet e identifikuar në qasjen dhe dhënien e shërbimeve.

## 2.2. Metodologjia

Në mënyrë që të shqyrtohet ndikimi i COVID-19 te qytetarët, si dhe te ndërmarrjet në Kosovë, UNDP ka porositur IDRA Research and Consulting në Kosovë që të kryejë edhe dy valë të tjera të vlerësimeve përmes anketave sasiore duke respektuar në mënyrë rigoroz metodologjinë e mëparshme të zhvilluar dhe të vendosur gjatë valës së parë të vlerësimit në maj 2020. Puna në terren e valës së dytë u krye në nëntor 2020 dhe ishte e përbërë nga mostrat e mëposhtme:

1. Anketa me ekonomi familjare, N=1,425 intervista
2. Anketa me ndërmarrje, N=601 intervista (krahasuar me valën 1, mostra e ndërmarrjeve është rritur trefish duke bërë të mundur një analizë më të saktë dhe precize të të dhënave.)

Mostrat e valës së parë ishin të përbërë nga:

1. Anketa e familjeve, N = 1,412
2. Anketa e biznesit, N = 202

### Anketa me ekonomi familjare

Mbledhja e të dhënave për anketën me ekonomi familjare u krye me metodën CATI (Intervistë Telefonike e Asistuar nga Kompjuteri). Një sistem i cili gjeneron rastësisht numra të telefonave mobil është përdorur si hap i parë i përzgjedhjes së anketuarve. Sistemi ka algoritme “të integruara” që zbulojnë segmentet e numrave mobil që janë në përdorim bazuar në informatat e dhëna nga operatori kur numri i gjeneruar në mënyrë të rastësishme del se nuk ekziston. Përgjatë viteve të funksionimit të sistemit, informatat vazhdimisht janë shtuar në databazë sa i përket vendndodhjes gjeografike të numrave që janë thirrur për hulumtime në të kaluarën. Prandaj ekziston mundësia që të parashikohet "vendndodhja" e numrit që do të thirret pasi të gjenerohet. Ky mjet siguron që kontaktet gjenerohen në mënyrë të rastësishme.

Pas gjenerimit të numrave, një pyetësor shqyrtues është përdorur për të përcaktuar nëse të anketuarit janë të përshtatshëm sipas kërkesave të mostrës:

- Vendndodhja (komuna)
- Zona e banimit: Urban/Rural
- Moshë
- Gjinia
- Niveli i arsimit
- Statusi i punësimit

Pasi u kontrollua dhe verifikua kuota, atëherë u bë intervista kryesore. Intervistat për Anketën me Ekonomi Familjare janë realizuar nga 11 nëntori deri më 27 nëntor 2020. Procesi shqyrtimit ndihmon monitorimin e fazës së mbledhjes së të dhënave, pasi siguron që secila intervistë e kryer të përshtatet me shpërndarjen e planifikuar e intervistave.

### Shpërndarja e mostrës

Shpërndarja e intervistave bazohet në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Përqindjet në tabelë që tregojnë përqindjen e popullsisë (mbi 18 vjeç) janë marrë nga të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2011. Gjithashtu, lloji i vendbanimit, gjinia dhe shpërndarja e moshës u bazua në të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2011, siç vërehet në tabelat më poshtë.

Bazuar në këto të dhëna, intervistat për çdo rajon janë paraparë si më poshtë:

Tabela 1. Shpërndarja e mostrës sipas rajonit

Rajoni	Përqindja	Intervista
Gjakovë	11%	150
Prishtinë	26%	376
Gjilan	11%	150
Prizren	18%	252
Pejë	10%	139
Ferizaj	11%	162
Mitrovicë	14%	196
Total	100%	1,425

Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas zonës së banimit

Zona e banimit	Përqindja	Intervista
Rural	56%	797
Urban	44%	628
Total	100%	1,425

Tabela 3. Shpërndarja e mostrës sipas gjinisë

Gjinia	Përqindja	Intervista
Gra	48%	688
Burra	52%	737
Total	100%	1,425

Tabela 4. Shpërndarja e mostrës sipas moshës

Mosha	Përqindja	Intervista
18-24	19%	276
25-34	24%	336
35-44	21%	301
45-54	17%	236



55-64	10%	144
65+	9%	132
Total	100%	1,425

Procesi i mbledhjes së të dhënave u monitorua nga afër për të arritur një shpërndarje të mjaftueshme në lidhje me statusin e punësimit pasi të papunët perceptohen si një grup veçanërisht i cenushtëm. Tabelat e mëposhtme tregojnë llogaritjet për numrin e intervistave

Tabela 5. Shpërndarja e mostrës sipas statusit të punësimit

Status	Përqindja	Intervista
Të vetë-punësuar	11%	163
Kontribuues në biznes familjar (pa pagesë)	1%	9
Të punësuar	39%	555
Të papunë	9%	129
Nxënës, studentë, duke ndjekur trajnime të mëtejshme, praktikë pa pagesë	7%	95
Në pension ose pension të parakohshëm, ose ka hequr dorë nga biznesi	10%	146
Me aftësi të kufizuara të përhershme	1%	5
Të angazhuar me punë shtëpiake	9%	127
Të dekurajuar/jo-aktivë të tjerë	13%	196
Total	100%	1,425

Marzha i gabimit për një mostër totale prej 1,425 intervistash në Kosovë llogaritet të jetë  $\pm 2.6\%$ .

### Anketa me ndërmarrje

Një anketë u realizua edhe me 601 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme. Mbledhja e të dhënave u realizua gjithashtu duke aplikuar CATI (Intervistë Telefonike e Asistuar nga Kompjuteri) dhe u zhvillua nga 13 nëntori deri më 30 nëntor 2020.

Një procedurë e marrjes së mostrave shumë-fazore është përdorur për të identifikuar bizneset e përshtatshme. Bizneset janë identifikuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), përmes informatave të mëposhtme:

- 1) NIPT (ekuivalent me numrin e identifikimit tatimor)
- 2) Emri i biznesit
- 3) Data e regjistrimit
- 4) Lloji i Ndërmarrjes (ShPK, SH.A., Person fizik, etj.)
- 5) Adresa
- 6) Kapitali Fillestar
- 7) Përfaqësuesi Ligjor
- 8) Statusi (aktiv, pasiv, nën falimentim)

Bazuar në këtë databazë, ndërmarrjet janë zgjedhur rastësisht sipas vendndodhjes dhe më pas kanë kaluar përmes një procedure shqyrtimi e cila është si më poshtë:

1. Kontaktohet ndërmarrja (duke përdorur kontakte nga databaza të ndryshme, ekstrakte nga këshilli kombëtar për kërkim, oda ekonomike, faqet e verdha, etj.)
2. Shqyrtimi (Vlerësimi) i ndërmarrjes (përmes një mini anketeje përmes telefonit) lidhur me:

- a. Madhësinë
- b. Rajonin

3. Nëse ndërmarrja i përshtatej kuotës, (kuota ndërlidhëse - rajoni, madhësia, pronësia), atëherë u caktua një takim për pyetëtorin kryesor.

Duhet theksuar se sektori i biznesit i Kosovës është i përbërë pothuajse tërësisht nga NMVM-të (ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme). Ka rreth 38,000 ndërmarrje të regjistruara që operojnë në Kosovë:

- 93.1% e të cilave janë ndërmarrje mikro,
- 5.9% janë të vogla dhe
- 0.9% janë të mesme.
- Vetëm 0.1% e popullsisë së përgjithshme të ndërmarrjeve klasifikohen si ndërmarrje të mëdha.

Klasifikimi i NVMV-ve në Kosovë përcaktohet me ligjin për investimet e huaja, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2014. Sa i përket shpërndarjes gjeografike të ndërmarrjeve, rreth një e treta e të gjitha ndërmarrjeve të regjistruara janë të vendosura në rajonin e Prishtinës. Më poshtë është shpërndarja e bizneseve në Kosovë, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (2018).

Tabela 6. Shpërndarja e ndërmarrjeve në Kosovë

Rajoni	Mikro (1-9)	Të vogla (10-49)	Të mesme (50-249)	Të mëdha (250+)	Total	Përqindja
Gjakovë	3,408	162	17	2	3,589	9%
Gjilan	3,580	233	20	0	3,833	10%
Mitrovicë	3,069	146	23	2	3,240	8%
Pejë	3,189	185	23	2	3,399	9%
Prizren	5,625	317	34	3	5,979	16%
Prishtinë	12,605	1,111	216	47	13,979	37%
Ferizaj	3,898	231	28	1	4,158	11%
Kosovë	35,374	2,385	361	57	38,177	100%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018

Siç ilustron nga tabelat e mësipërme dhe ajo më poshtë, nëse shpërndarja e mostrës do bazohej në të dhënat zyrtare, atëherë nuk do të ishte e mundur të analizohen të dhënat sipas kategorisë së ndërmarrjes (mikro, të vogla dhe të mesme) për shkak të një numri shumë të vogël të anketave për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në mënyrë proporcionale. Prandaj, për të pasqyruar me saktësi shtrirjen e bizneseve në Kosovë, kuotat dhe peshat e mëposhtme janë aplikuar për mostrën e anketës me ndërmarrje. Përveç madhësisë së ndërmarrjes, kuotat u zbatuan për shpërndarjen rajonale, si dhe për aktivitetin ose industrinë kryesore të biznesit. Mostra sipas kuotave mundëson analizimin dhe ofrimin e gjetjeve për të tre kategoritë e ndërmarrjeve veç e veç. Prandaj, në këtë raport, rezultatet e

përgjithshme janë peshuar. Procedura e peshimit siguron që rezultatet të paraqesin shtrirjen e ndërmarrjeve në Kosovë, që do të thotë se segmenti i ndërmarrjeve kontribuon me të njëjtën pjesë ose peshë që ka në përgjithësi në Kosovë.

Prandaj, kuotat dhe peshat e mëposhtme u aplikuan për mostrën e anketës me ndërmarrje:

Tabela 7. Mostra dhe peshimi për mostrën e Anketës me Ndërmarrje

Madhësia e ndërmarrjes	Përqindja e ndërmarrjeve në Kosovë (të dhënat zyrtare)	Anketa (intervistat)		Pas peshimit <sup>7</sup>
		Përqindja	Ndërmarrjet	Përqindja
Mikro (1-9)	93.10%	55%	328	93.10%
Të vogla (10-49)	5.90%	33%	199	5.90%
Të mesme (50+)	1.00%	12%	74	1.00%
Total	100%	100%	601	100%

<sup>7</sup> Rezultatet e përgjithshme në grafikë tregohen si të ponderuara/peshuara.

# 3. Gjetjet e anketës

### 3.1. Anketa me ekonomi familjare

Ky kapitull paraqet gjetjet e valës së dytë të anketës së ekonomive familjare. Kur është e zbatueshme, të dhënat krahasohen me rezultatet e valës së parë të vlerësimit të kryer në maj të vitit 2020.

#### 3.1.1 Profili i Familjeve dhe Karakteristikat Demografike

Shpërndarja gjinore e të anketuarve që morën pjesë në anketën e familjeve ishte gati e barabartë (52% burra dhe 48% gra). Mbi 40% ishin mes moshës 25 dhe 44 vjeç, ndërsa 19% i përkisnin grupmoshës më të re nga 18 deri në 24 vjeç. Gati një e treta ishin mes 45 dhe 54 vjeç, ndërsa 9% ishin 65 vjeç apo më të vjetër.

Figura 1 Gjinia e të anketuarve





Figura 2 Moshë e të anketuarve



Sikurse gjatë valës së parë të këtij vlerësimi, mostra e përzgjedhur ishte gjithashtu përfaqësuese e strukturës së popullsisë së Kosovës. Rreth 26% ishin nga Prishtina, 18% nga Prizreni, ndërsa 14% ishin nga Mitrovica. Nga rreth 11% prej të anketuarve ishin nga Ferizaji, Gjakova dhe Gjlani, ndërsa 10% ishin nga Peja. Duke iu përgjigjur shpërndarjes së përgjithshme urbane/rurale të popullsisë në Kosovë, shumica e të anketuarve ishin nga zonat urbane (56%), ndërsa 44% vinin nga zonat rurale.

Figura 3 Shpërndarja rajonale e të anketuarve





Figura 4 Zona e banimit



Niveli arsimor i të anketuarve është i ndryshëm, shumica e të cilëve kanë përfunduar arsimin e mesëm (53%), e pothuajse një në katër ka përfunduar nivelin universitar ose ekuivalent (24%) dhe 18% kanë përfunduar shkollën fillore. Ndërsa 4% kanë përfunduar arsimin pasuniversitar, 2% deklarojnë se nuk kanë fare arsim.

Përkatësia etnike e të anketuarve rezultoi në 92% shqiptarë, 7% serbë të Kosovës ndërsa një përqind i përkisnin etnive të tjera ndryshe nga ato të lartpërmendurat.

Figura 5 Niveli i arsimit i të anketuarve






Figura 6 Etnia e të anketuarve




Më shumë se dy në tre të anketuar deklaruan se janë të martuar (67%), ndërsa gati një e treta deklaroi se ishin beqarë (29%). Rreth 4% raportuan se ishin të ve dhe vetëm 1% deklaruan të ishin të ndarë ose të divorcuar.

Figura 7 Statusi civil i të anketuarve



Pothuajse dy të tretat e familjeve kishin fëmijë (61%) dhe rreth një e treta kishin anëtarë të moshuar të familjes si pjesë e familjeve të tyre (34%). Numri mesatar i fëmijëve ishte 2.1, ndërsa numri mesatar i të rriturve dhe të moshuarve ishin përkatësisht 3.6 dhe 1.4, në secilën familje. Vetëm tre përqind e familjeve kishin një anëtar të familjes që ishte shtatzënë në kohën e intervistës. Shumica dërrmuese deklaruan të jetonin në një ndërtesë banesore kolektive (95%).


Figura 8 Përbërja e familjes



Përbërja e familjes		
	Mesatarja	Moda
Numri i fëmijëve 0-17 vjeç	2.1	2
Numri i të rriturve 18-64 vjeç	3.6	2
Numri i të moshuarve 65+ vjeç	1.4	1

Të ardhurat e përbashkëta të familjes përgjithësisht silleshin nga rreth 400 deri në 799 Euro (28%) në muaj. Rreth 21% deklaruan të ardhura në mes 250 dhe 399 Euro, ndërsa gati po aq deklaruan se të ardhurat e tyre janë nga zero deri në 249 Euro (19%). Një në dhjetë deklaroi se mbledh 800 deri në 1,199 Euro në muaj (10%). Vetëm 3% e të gjithë të anketuarve kishin të ardhura totale mujore të familjes prej 1,200 Euro ose më shumë. Duhet të theksohet se 20% e të gjithë të anketuarve nuk kanë dhënë përgjigje për këtë pyetje.


Figura 9 Të ardhurat e familjes në muaj



Kur u pyetën nëse të ardhurat e familjes janë ulur ose janë rritur që nga shpërthimi i pandemisë COVID-19, më shumë se dy në pesë të anketuar deklaruan se të ardhurat e tyre ishin ulur (43%). Mesatarisht, të ardhurat janë ulur me 199 Euro në muaj. Përgjigja më e zakonshme (moda) tregonte një ulje prej 200 Eurosh.


Vetëm dy përqind kishin parë një rritje në të ardhurat e tyre që nga fillimi i pandemisë, me një mesatare prej 244 Euro në muaj. Shumica deklaroi se situata e tyre e të ardhurave nuk ka ndryshuar (52%).

Figura 10 Ndryshimet në të ardhura për muaj që nga pandemia e COVID-19



Duke i ndarë sipas grupit të të ardhurave, rritja më e madhe e të ardhurave u ka ndodhur familjeve, të ardhurat mujore të të cilave janë 1,200-2,000 Euro (12%) dhe më shumë se 2,000 Euro (8%). Interesante, edhe ulja më e madhe në të ardhurat familjare u perceptua nga ato familje me të ardhura të përbashkëta prej 2,000 Eurosh ose më shumë (50%), përcjellë nga ato që fitojnë 200-399 Euro në muaj (46%).


Figura 11 A kanë ndryshuar të ardhurat e familjes pas pandemisë COVID-19?, sipas të ardhurave aktuale të familjes





Pjesa më e madhe e familjeve nuk kishin asnjë anëtar të familjes me nevoja të veçanta (94%), ndërsa 4% deklaruan se kishin një anëtar me nevoja të veçanta mesatare (mesatarisht 1.1 anëtarë) dhe 2% me nevoja të veçanta (mesatarisht 1.1 anëtarë) të rënda në familjet e tyre.

Figura 12 Numri i personave me nevoja të veçanta në familje




### 3.1.2 Vetëdijësimi dhe Informimi rreth COVID-19

Qëllimi i kësaj pjese të anketës ishte të kuptojë se si njerëzit në Kosovë informohen rreth virusit COVID-19, nëse u besojnë burimeve përkatëse dhe analizave, dhe nëse respektohen masat kufizuese në vend. Po ashtu vlerëson gatishmërinë e të anketuarve për të marrë vaksinën kundër COVID-19, nëse u vihet në dispozicion.

Së pari, të anketuarit u pyetën për burimin e tyre kryesor të informacionit të përdorur për të marrë njohuri rreth COVID-19. Pyetësi gjithashtu kapi se cili nga burimet është më i besueshmi. Ngjashëm me rezultatet e valës 1 të vlerësimit të kryer në maj të vitit 2020, të anketuarit përdorën më së shumti radio, televizion dhe gazeta (89%). Këto burime janë gjithashtu më të besueshmet sipas 78% të të anketuarve. Përdorimi dhe besimi ndaj këtyre burimeve janë ulur deri diku përkatësisht me 3 dhe 5 pikë përqindje (pp).


Interneti dhe rrjetet sociale u përmendën nga gati tre në katër të anketuar si burimi kryesor i informacionit në lidhje me COVID-19 (73%). Besimi në këto burime është rritur pak që nga maji i vitit 2020 (3 pp). Ndërsa komuniteti i të anketuarve ka qenë burimi kryesor i informacionit për gati një të tretën (28%) në valën 1, në nëntor 2020 vetëm 18% deklaruan të njëjtën gjë. Në anën tjetër, përdorimi i aplikacioneve të telefonit për të marrë informacion është rritur. Asnjë ndryshim thelbësor nuk është vërejtur në lidhje me përdorimin (19%) dhe besimin (11%) në uebfaqet zyrtare të qeverisë, megjithatë, njoftimet e shërbimeve publike u cituan nga më pak (12%) krahasuar me valën 1 (20%), besimi në këtë burim ka rënë gjithashtu (5 pp). Marrja e informacionit nga OJQ-të u përmend nga vetëm 2% e të anketuarve (shih Figurën 13).

Figura 13 Burimet kryesore të informacionit dhe burimet më të besueshme të informacionit




Kur analizohen burimet kryesore të informacionit sipas moshës së të anketuarve, mund të vërehet se të anketuarit më të rinj kishin më shumë gjasa të përdorin internetin dhe rrjetet sociale si burimin e tyre kryesor të informacionit. Të anketuarit e moshuar janë më të prirur të përdorin radio, televizion dhe gazeta. Përdorimi i komunitetit si burim kryesor i informacionit për COVID-19 duket se ishte më i zakonshmi në mesin e të anketuarve të moshës së mesme (45 deri në 64 vjeç) me rreth një në tre që e përmendën atë.

Figura 14 Burimet kryesore të informacionit, sipas moshës




Burimet më të përdorura të informacionit për burra dhe gra ishin radio /televizion/ gazetë dhe internet dhe rrjete sociale. Tetëdhjetë e pesë përqind e burrave dhe 86% e grave përdorin radio/televizion/ gazetë; 72% e burrave dhe 75% e grave përdorin internet dhe rrjete sociale. Burimi i tretë më i përdorur i informacionit në lidhje me lajmet COVID-19 për burrat dhe gratë ishin komunitetet e tyre, duke përfshirë familjen dhe miqtë, megjithëse më pak (përkatësisht 27% dhe 28%) (shih Figurën më poshtë).

Figura 15 Burimet kryesore të informacionit, sipas gjinisë




Sa i përket zonës së banimit, 86% e njerëzve që jetojnë në zona urbane dhe 85% e atyre që jetojnë në zona rurale përdorin më shumë mediat tradicionale (radio/televizion/gazetë) për qëllime informacioni rreth COVID-19. Shtatëdhjetë e tetë përqind e njerëzve në zonat urbane përdorin gjithashtu internet dhe rrjete sociale, ndërsa vetëm 69% e atyre në zonat rurale përdorin këto kanale informacioni. Ka një ndryshim më të madh në përdorimin e telefonit përmes aplikacioneve të ndryshme të komunikimit (Viber, Telegram, WhatsApp, ndër të tjera) ku 24% e banorëve urbanë dhe 18% e banorëve ruralë i përdorin ato. Megjithëse pjesë më të vogla të banorëve urban dhe rural përdorin uebfaqet zyrtare të qeverisë si burime të informacionit, një në katër banorë që jetojnë në zona urbane (25%) dhe rreth një në shtatë banorë që jetojnë në zona rurale (14%) i përdorin ato (shih Figurën 16).

Figura 16 Burimet kryesore të informacionit, sipas zonës së banimit




Duke marrë parasysh nivelin e arsimit të të anketuarve, burimet më të përdorura të informacionit mbeten të njëjtat, pavarësisht nga niveli i arsimit. Sidoqoftë, ka ndryshime në përqindjen e njerëzve me arsim fillor ose të ulët, arsim të mesëm dhe universitet ose arsim të lartë që i përdorin ato. Më shumë njerëz me arsim fillor ose të ulët (94%) përdorin media tradicionale sesa ata me arsim të mesëm (85%) dhe me universitet ose arsim të lartë (81%). Rreth dy në katër persona (42%) me arsim fillor ose të ulët përdorin internet dhe rrjete sociale, ndërsa pak më shumë se tre në katër (77%) njerëz me arsim të mesëm dhe rreth shtatë në tetë persona (88%) me arsim universitar apo më të lartë i përdorin ato.

Figura 17 Burimet kryesore të informacionit, sipas nivelit të arsimit




Sa i përket burimeve më të besueshme të informacionit, të dhënat sugjerojnë se besimi në internet dhe rrjete sociale zvogëlohet me moshë, ndërsa besimi në radio, televizion dhe gazeta rritet me moshë. Uebfaqet zyrtare të qeverisë besoheshin më shpesh nga të anketuar më të rinj, sesa nga ata mbi 45 vjeç. Përkundër një numri të konsiderueshëm të të anketuarve të moshës së mesme të cilët përmendën komunitetin si burimin e tyre kryesor, besimi duket të jetë i ulët me vetëm 5-10%.

Figura 18 Burimet më të besueshme të informacionit, sipas moshës




Për të vlerësuar nëse informatat e marra në lidhje me COVID-19 ishin perceptuar si të dobishme, të anketuarve iu kërkua të shprehin nivelin e tyre të pajtimit me deklaratën "Informatat rreth COVID-19 më kanë ndihmuar ta mbrojt veten dhe familjen nga virusi". Ngjashëm me rezultatet e valës 1, shumica e të anketuarve shprehën pajtim apo pajtim të plotë me deklaratën në shkallën prej 1.0 në 5.0 (4.3 nga 5.0 pikë).

Figura 19 Niveli i pajtimit me deklaratën: "Informatat rreth COVID-19 më kanë ndihmuar ta mbrojt veten dhe familjen nga virusi"




Duke marrë parasysh gjininë e të anketuarve, gratë u pajtuan pak më shumë sesa burrat se informacioni në lidhje me COVID-19 i ndihmoi ato të mbrojnë veten dhe familjet e tyre nga virusi, duke vlerësuar deklaratën “Informatat rreth COVID-19 më kanë ndihmuar ta mbroj veten dhe familjen nga virusi” me 4.2 pikë nga 5 në krahasim me burrat që e vlerësuan atë me 4 pikë nga 5, në një shkallë të pajtimit.

Figura 20 Niveli i pajtimit me deklaratën: "Informatat rreth COVID-19 më kanë ndihmuar ta mbroj veten dhe familjen nga virusi"



Të anketuarve gjithashtu iu kërkua të vlerësonin në një shkallë nga 1.0 deri në 5.0 nëse ata mendonin se njerëzit në komunitetin e tyre respektuan masat parandaluese kundër COVID-19 deri më tani. Gjetjet e përgjithshme të të dhënave sugjeruan që të anketuarit perceptuan që komuniteti i tyre në përgjithësi respektoi masat (3.8 nga 5.0 pikë).

Figura 21 Niveli i pajtimit me deklaratën: "Njerëzit në komunitetin tim respektojnë masat parandaluese kundër COVID-19"




Meqë bota është duke shpejtuar fillimin e fushatave të vaksinimit për COVID-19, një pyetje u përfshi në anketë për të zbuluar nëse të anketuarit do të ishin të gatshëm të vaksinoheshin kur vaksinat të jenë në dispozicion. Në përgjithësi, rreth një në katër të anketuar deklaruan se nuk do ta konsideronin kurrë vaksinën (24%), 20% të tjerë deklaruan se anojnë nga mos vaksinimi. Në anën tjetër, 21% deklaruan se do të vaksinoheshin patjetër dhe 16% deklaruan se anojnë drejt vaksinimit. Duhet të theksohet se 19% nuk e dinin përgjigjen për këtë pyetje.

Duke vështruar rezultatet e të dhënave sipas moshës, mund të vërehet se të anketuarit që ishin 65+ vjeç përfaqësuan grupin që ishin më të prirur për t'u vaksinuar, ndërsa ata mes moshës 25 deri në 34 ishin më pak të prirur. Grupmosha 25 deri 34 vjeç treguan shkallën më të lartë të përgjigjes negative për këtë pyetje (50%).




Figura 22 Gatishmëria për t'u vaksinuar për COVID-19, sipas moshës




Burrat ishin më të gatshëm të vaksinoheshin nëse do ju jepej mundësia sesa gratë. Rreth 39% e burrave dhe 35% e grave ose do të vaksinoheshin patjetër ose më së shumti anojnë nga vaksinimi. Dyzet e pesë përqind e burrave ose nuk do të vaksinoheshin ose më së shumti anojnë nga mos vaksinimi në krahasim me 33% të grave. Më shumë gra (22%) sesa burra (16%) nuk janë të sigurt nëse do të vaksinoheshin apo jo.

Figura 23 Gatishmëria për t'u vaksinuar për COVID-19, sipas gjinisë




Të anketuarit që banojnë në rajonin e Gjakovës dhe Prishtinës treguan gatishmërinë më të lartë nga të anketuarit të cilët do të vaksinoheshin patjetër ose anojnë nga vaksinimi (45% dhe 44% përkatësisht). Ndërsa, në Gjilan dhe Mitrovicë vetëm 24% dhe 23% përkatësisht deklaruan të njëjtën gjë. Numri më i lartë i të anketuarve të cilët kryesisht anonin nga mos vaksinimi ose deklaruan se nuk do të vaksinoheshin kurrë ishin nga Mitrovica (përkatësisht 39% dhe 17%).

Figura 24 Gatishmëria për t'u vaksinuar për COVID-19, sipas rajonit



Për më tepër, kur merren parasysh rezultatet e të dhënave që kanë të bëjnë me gatishmërinë e vaksinimit të ndara sipas përkatësisë etnike, del qartë se të anketuarit shqiptarë kishin më shumë të ngjarë të pajtoheshin me marrjen e vaksinës COVID-19 (22% do të vaksinoheshin patjetër, 16% anonin drejt vaksinimit) sesa të anketuarit serbë. Vetëm 7% e serbëve planifikojnë të vaksinohen patjetër, ndërsa 10% anojnë nga ai opsion. Sidoqoftë duhet të theksohet se gati një e treta e serbëve të Kosovës nuk dinin përgjigje për këtë pyetje (31%).

Figura 25 Gatishmëria për t'u vaksinuar për COVID-19, sipas përkatësisë etnike



### 3.1.3 Arsimi/Mësimi në distancë

Që nga shtatori i vitit 2020, shumica e fëmijëve në Kosovë po ndiqnin shkollën përsëri personalisht ose ishin pjesë e një sistemi rotacioni. Më parë, institucionet e Kosovës po ofronin mësim në distancë duke e transmetuar atë përmes transmetuesit publik gjatë periudhës më të rreptë të bllokimit midis marsit dhe majit 2020. Në këtë pjesë të anketuarit u pyetën nëse fëmijët e tyre ende po mësonin në distancë ose nëse ata janë përsëri duke ndjekur mësimin personalisht dhe nëse ata ishin në gjendje të ndiqnin mësimin në distancë. Perceptimi mbi cilësinë e mësimin në distancë vlerësohet gjithashtu në këtë seksion ndër të tjera.

Nga 1,425 të anketuar, 704 (49%) deklaruan se kishin fëmijë që shkonin në shkollë. Gati tre në katër fëmijë shkonin fizikisht në shkollë në kohën e intervistës (72%). Rreth 20% ishin pjesë e një sistemi rotacioni dhe shkonin në shkollë fizikisht në disa ditë dhe vijonin mësimin në distancë në ditët tjera. Vetëm 8% në total mësuuan tërësisht në distancë në nëntor 2020 (shih figurën më poshtë).

Figura 26 Familjet me fëmijë të moshës shkollore






Figura 27 Ndjekja e mësimin fizikisht ose në distancë




Të anketuarit u pyetën nëse familja e tyre kishte pajisje teknike të nevojshme për fëmijën/fëmijët e tyre për të ndjekur programin e mësimin në distancë. Pothuajse të gjithë kishin një televizion në familjen e tyre (99%), ndërsa 92% kishin një kompjuter/laptop ose Tabelat me qasje në internet. Pothuajse dy të tretat kishin gjithashtu një telefon të mençur me lidhje interneti(63%).

Figura 28 Posedimi i pajisjeve të nevojshme teknike që fëmijët të jenë në gjendje të ndjekin mësimin në distancë




Nëntëdhjetë e nëntë për qind e familjeve urbane dhe rurale kishin një televizion; ndërsa 95% e familjeve urbane dhe 90% e familjeve rurale kishin kompjuter, laptop ose Tabelat me lidhje interneti. Më shumë ndryshime vërehen në lidhje me posedimin e një telefoni të mençur me qasje në internet, ku 75% e familjeve urbane deklaruan se kishin një dhe vetëm 55% e familjeve rurale deklaruan të njëjtën gjë (shih figurën më poshtë).

Figura 29 Posedimi i pajisjeve të nevojshme teknike që fëmijët të jenë në gjendje të ndjekin mësimin në distancë, sipas zonës së banimit




Kur vështrohen dallimet rajonale, të gjithë njerëzit në Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë dhe Prizren kanë një televizion. Ndërsa disa njerëz në Ferizaj (4%), Pejë (3%) dhe Prishtinë (1%) nuk kanë televizion. Të anketuarit në Gjilan kanë më pak kompjuterë, laptopë, apo tabletë me lidhje interneti (vetëm 75% e tyre), dhe në Prishtinë (87%). Rreth 54% e familjeve në Gjilan, 42% në Prizren, 40% e familjeve në Prishtinë dhe nga 36% e familjeve në Ferizaj dhe Pejë nuk kanë telefona të mençur me qasje në internet. Ju lutemi vini re se këto të dhëna janë në një nivel rajonal, kështu që të gjitha familjet urbane dhe rurale konsiderohen. Sa më të mëdha rajonet, kështu duket se është më e lartë mundësia që disa familje do të kenë mungesë të teknologjisë, veçanërisht telefonave të mençur me lidhje interneti (shih figurën më poshtë).

Figura 30 Posedimi i pajisjeve të nevojshme teknike që fëmijët të jenë në gjendje të ndjekin mësimin në distancë, sipas rajonit




Ata të anketuar që kishin fëmijë në familjet e tyre të cilët ende po vijonin mësimin në distancë u pyetën gjithashtu nëse fëmijët ishin në gjendje të merrnin pjesë rregullisht në mësimin në distancë. Vetëm në tetë raste (15%) fëmijët nuk ishin në gjendje të ndiqnin rregullisht mësimin në distancë (rezultat indikativ). Arsyeja më e zakonshme për këtë ishte se disa fëmijë duhej të përdornin të njëjtën pajisje, ose një anëtar tjetër të shtëpisë i duhej të përdorte pajisjet për punë në distancë.

Figura 31 Fëmijët në familje ishin në gjendje të ndiqnin rregullisht mësimin në distancë



Në një shkallë nga 1.0 në 5.0, të anketuarit që kanë fëmijë që ndjekin rregullisht mësimin në distancë vlerësuan cilësinë e të mësuarit në distancë me 3.3 pikë që përkthehet në një vlerësim neutral.

Figura 32 Niveli i pajtimit me deklaratën “Cilësia e arsimit të ofruar përmes mësimave në distancë ishte e cilësisë së lartë”




### 3.1.4 Punësimi dhe burimet e jetesës

Kjo pjesë shqyrton se si pandemia COVID-19 ka ndikuar në punësimin dhe jetesën e të anketuarve. Po ashtu krahason ndër të tjera ndryshimet në lidhje me statusin dhe llojin e punësimin, ndryshimin në orët e punës, pagesat dhe ditët e pushimeve.

Gati dy në pesë të anketuar raportuan të kenë qenë të punësuar për një person, kompani apo institucion para pandemisë (37%). Për më tepër, 11% të tjerë të të anketuarve ishin të vetëpunësuar. Ndërsa, 11% e të anketuarve ishin të papunë pa kërkuar në mënyrë aktive punë, 9% e tyre ishin të papunë por që kërkonin punë, dhe 9% ishin përgjegjës për t'u kujdesur për familjen dhe punët e shtëpisë dhe kështu nuk kërkuan punë. Dhjetë përqind e të anketuarve deklaruan të jenë në pension.


Diferenca në statusin e punësimin midis valës 1 dhe valës 2 është e vogël, brenda kufirit të marzhës së gabimit prej 4%, ku për shumicën e statuseve ka një ndryshim 1% midis dy valëve.

Figura 33 Statusi i punësimit para COVID-19, vala 1 vs. vala 2




Kur vlerësohet statusi i punësimit para COVID-19 sipas gjinisë, del se 48% e grave nuk punonin, nga këto 12% kërkonin punë. Në krahasim, vetëm 12% e burrave nuk ishin duke punuar, nga këta 7% ishin në kërkim të një pune. Për më tepër, askush nga burrat nuk deklaroi të kujdeset për punët e shtëpisë ndërsa nuk kërkonte punë, krahasuar me 18% të grave që e bënin këtë.

Figura 34 Statusi i punësimit para COVID-19, sipas gjinisë



Gjetjet e të dhënave të ndara sipas përkatësisë etnike sugjerojnë se një përqindje dukshëm më e lartë e të anketuarve serbë punonin për një person, kompani apo institucion para COVID-19 (70%) sesa të anketuarit shqiptarë (35%). Një përqindje më e lartë e të anketuarve shqiptarë deklarojnë se janë të papunë ndër sa nuk kërkojnë punë (12%) sesa të anketuarit serbë (2%).

Figura 35 Statusi i punësimit para COVID-19, sipas përkatësisë etnike





Para shfaqjes së COVID-19, gati tre në katër të anketuar punonin për sektorin privat (73%), ndërsa 27% punonin për sektorin publik. Këto gjetje janë në përputhje me ato të mëparshme të mbledhura gjatë valës së parë të SEIA.

Figura 36 Sektori i punësimit para COVID-19, vala 1 vs. vala 2



Të anketuarit serbë kishin një pjesë shumë më të lartë të punësimit në sektorin publik (73%) sesa të anketuarit shqiptarë (21%). Më pas, të dhënat tregojnë përqindjen më të lartë të të anketuarve të punësuar në sektorin publik në Mitrovicë (50%) ku jetojnë shumica e serbëve të Kosovës. Gati një e treta e të anketuarve nga rajoni i Gjilanit ishin gjithashtu të punësuar në sektorin publik. Punësimi më i ulët në sektorin publik është vërejtur në Gjakovë.

Figura 37 Sektori i punësimit para COVID-19, sipas përkatësisë etnike





Figura 38 Sektori i punësimit para COVID-19, sipas rajonit



Gati një në tri gra ishin të punësuar në sektorin publik (31%), ndërsa 25% e burrave gjithashtu punonin në sektorin publik.

Figura 39 Sektori i punësimit para COVID-19, sipas gjinisë



Të anketuarit nga zonat urbane ishin më shpesh të punësuar në sektorin publik (33%), sesa ata që banonin në zonat rurale (22%).


Figura 40 Sektori i punësimit para COVID-19, sipas zonës së banimit



Rezultatet e të dhënave më tej zbuluan se të anketuarit më të rinj kishin më shumë gjasa të punonin në sektorin privat sesa më të moshuarit. Pjesa më e madhe e të anketuarve 18-24-vjeçarë kanë punuar në sektorin privat (95%), si dhe 79% të atyre brenda grupmoshës 25 deri 34 vjeç.

Më shumë se një në tre të anketuar mbi moshën 35 vjeç deklarohen se kanë punuar në sektorin publik.

Figura 41 Sektori i punësimit para COVID-19, sipas moshës




Restorantet, kafenetë dhe hotelet punësonin 15% të të gjithë të anketuarve që punonin para shpërthimit të COVID-19, ndërsa 13% ishin të punësuar në sektorin publik dhe 12% secili merreshin me ndërtim ose arsim/shëndetësi. Një tjetër 11% ishin të punësuar në tregtinë me pakicë.

Rezultatet e të dhënave që kanë të bëjnë me aktivitete të ndryshme të biznesit të ndara sipas gjinisë tregojnë se gratë ishin dukshëm më të pranishme në arsim dhe shëndetësi (23%) sesa burrat (7%). Ndërtimtaria ende mban pjesën më të madhe të burrave (17%), ndërsa vetëm 0.5% e grave deklaruan se kanë punuar në këtë

aktivitetit biznesi. Gratë gjithashtu paraqitën një përqindje më të lartë të të punësuarve në tregtinë me pakicë (14%) sesa burrat (10%).

Figura 42 Punësimi sipas aktivitetit të biznesit, sipas gjinisë




Pyetjet e shtruar në lidhje me llojin e punësimit, sektorin dhe aktivitetin e biznesit i përkisnin periudhës kohore të paktën një javë para shpërthimit të COVID-19. Të anketuarit pastaj u pyetën për ndryshimet e tyre në orët e punës për shkak të, dhe që prej, pandemisë.

Gjysma e të gjithë të anketuarve deklaruan se nuk kishin përjetuar ndryshime në orët e tyre të punës (50%) që nga fillimi i pandemisë, krahasuar me valën 1 të vlerësimit, ku vetëm 22% nuk raportuan asnjë ndryshim në orët e punës që nga fillimi i pandemisë. Dy në dhjetë të anketuar kanë përjetuar ulje të orëve të punës pa humbur punën e tyre (20%), ndërsa 11% raportuan se e kishin humbur punën e tyre (vetëm 8% raportuan humbjen e punës gjatë valës 1 të SEIA).


Në nëntor 2020, rreth 4% deklaruan se mbetën të punësuar pa kryer ndonjë punë. Për krahasim, në maj të vitit 2020, 40% raportuan se kishin mbetur të punësuar pa u angazhuar në ndonjë punë. Heqja e fazës së bllokimit të rreptë në Kosovë dhe rihapja graduale e shoqërisë në qershor 2020 mbështesin këto gjetje.

Figura 43 Ndryshimet në orët e kushtuara punës në krahasim me situatën para-COVID-19, vala 1 vs. vala 2




Shumica e grave nuk raportuan asnjë ndryshim në orët kushtuar punës në krahasim me situatën para-COVID-19 (53%), ndërsa 49% e burrave gjithashtu nuk raportuan asnjë ndryshim. Pak më shumë burra deklaruan se orët e tyre të punës nuk ndryshuan, megjithatë, paga e pak më shumë prej tyre ishte zvogëluar (9%) krahasuar me gratë (6%). Rreth 20% e burrave dhe 18% e grave deklaruan se orari i tyre i punës u zvogëluar, por që ata nuk e humbën punën e tyre. Pak nga burrat (5%) dhe gratë (4%) ishin të punësuar, por nuk po punonin për momentin. Nuk kishte ndonjë ndryshim të rëndësishëm midis përqindjes së burrave dhe grave që kishin humbur punën e tyre (12% gra, 11% burra).

Figura 44 Ndryshimet në orët e kushtuara punës në krahasim me situatën para-COVID-19, sipas gjinisë




Kur krahasojmë gjetjet e mësipërme të ndara sipas gjinisë me ndarjen gjinore të valës 1 mund të vërehet se shumë më tepër gra kishin humbur punën e tyre në nëntor 2020 (12%) krahasuar me maj 2020 (5%). Më shumë burra gjithashtu humbën punën e tyre në nëntor 2020, megjithatë, rritja arriti në vetëm 2pp ndërsa rritja për gratë ishte 7pp. Në maj të vitit 2020 në mënyrë të konsiderueshme më shumë gra ishin të punësuaruara ndërsa nuk ishin të përfshira në ndonjë punë (39%) krahasuar me nëntorin e vitit 2020 (4%), e njëjta gjë vlen për burrat. Pak më pak gra (18%) dhe burra (20%) raportuan zvogëlim të orëve pa humbur punën në nëntor 2020 krahasuar me rezultatet e majit 2020 (përkatësisht 23% dhe 21%). Ndërsa vetëm 23% dhe 21% e grave dhe burrave respektivisht nuk raportuan asnjë ndryshim në orët e punës në maj 2020, ato përqindje u rritën në 53% dhe 49% përkatësisht.

Figura 45 Ndryshimet në orët e kushtuara punës në krahasim me situatën para-COVID-19, sipas gjinisë



Më shumë se dy të tretat e të anketuarve të angazhuar në sektorin publik nuk raportuan asnjë ndryshim në orët e punës për shkak të pandemisë COVID-19 (68%), krahasuar me 44% që punuan për sektorin privat. Zvogëlimi i orëve të punës ishte më i theksuar në sektorin privat (24%) sesa në sektorin publik (9%). Sektori privat gjithashtu regjistroi nivele dukshëm më të larta të humbjes së punës (15%) sesa në sektorin publik (2%).


Figura 46 Ndryshimet në orët e kushtuara punës në krahasim me situatën para-COVID-19, sipas sektorit të punësimit



COVID-19 ka pasur ndikime të ndryshme në punësim brenda aktiviteteve të ndryshme të biznesit. Shembuj të aktiviteteve të biznesit të cilat nuk përballen me nivele të larta të zvogëlimit të orëve të punës ose humbjes së punës janë shërbimet profesionale, arsimi/shëndetësia, sektori publik, shitja me shumicë dhe bujqësia.

Në anën tjetër, të anketuarit që punonin në restorante, kafene dhe hotele kishin më shumë mundësi të kenë humbur punën e tyre (23%), përcjellë nga punëtorët e ndërtimit (18%) dhe ata që merren me tregti me pakicë (15%). Të anketuarit e angazhuar në tekstil/veshmbathje (18%), shërbime profesionale (13%) dhe arsim/shëndetësi (14%) më shpesh raportuan rritje të orëve të punës sesa të tjerët.


Figura 47 Ndryshimet në orët e kushtuara punës në krahasim me situatën para-COVID-19, sipas aktiviteteve të biznesit



Në mënyrë që të vlerësohen më tutje mekanizmat e ndryshëm të përballimit të përdorura nga institucionet dhe kompanitë, anketa pastaj pyeti nëse të anketuarit ishin të detyruar të marrin pushim për shkak të pandemisë COVID-19.


Pothuajse tre në katër të anketuar raportuan se nuk ishin të detyruar të marrin ndonjë pushim (71%), 10% duhej të marrin pushim pa pagesë dhe 9% u kërkohet të marrin pushim me pagesë. Vetëm 4% duhej të marrin pushim pjesërisht të paguar. Punonjësit e sektorit publik kishin konsiderueshëm më shumë gjasa të kishin marrë pushim me pagesë (16%) sesa ata të angazhuar në sektorin privat (5%). Rreth 14% e të anketuarve që kanë punuar në sektorin privat u është kërkuar të marrin pushim pa pagesë, krahasuar me vetëm 1% në sektorin publik.

Figura 48 Detyrimi për marrjen e pushimit (leje) për shkak të pandemisë, sipas sektorit



Gjatë valës 1 të SEIA më shumë të anketuar kishin raportuar të kishin marrë pushim pa pagesë (18%) krahasuar me valën 2 (10%). Ndërsa 71% e të anketuarve raportuan se nuk morën asnjë lloj pushimi në nëntor, vetëm 58% kishin deklaruar të njëjtën gjë në maj 2020.


Figura 49 Detyrimi për marrjen e pushimit (leje) për shkak të pandemisë, vala 1 vs. vala 2






Kur analizohen të dhënat e ndara sipas përkatësisë etnike, bëhet e qartë se pothuajse të gjithë të anketuarit serbë nuk ishin të detyruar të marrin ndonjë pushim (93%), ndërsa vetëm 68% e të anketuarve shqiptarë të raportuan të njëjtën gjë.

Figura 50 Detyrimi për marrjen e pushimit (leje) për shkak të pandemisë, sipas përkatësisë etnike




Shumica e burrave (72%) dhe grave (70%) nuk morën pushim me detyrim. Njëmbëdhjetë përqind e grave morën pushim pa pagesë ndërsa vetëm 9% e burrave e bënë këtë. Po aq gra morën pushim me pagesë të plotë dhe 8% e burrave bënë të njëjtën gjë. Ndërsa, edhe pse më pak, më shumë burra (4%) sesa gra (3%) morën pushime pjesërisht të paguara.

Figura 51 Detyrimi për marrjen e pushimit (leje) për shkak të pandemisë, sipas gjinisë




Pastaj, të anketuarit u pyetën nëse vendi i tyre tipik i punës ndryshoi që kur u shfaq pandemia. Të dhënat tregojnë se shumica dërrmuese e njerëzve që janë kthyer në punë. Në përgjithësi, 89% deklaruan se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim dhe puna ende zhvillohet jashtë shtëpisë së tyre. Ndërsa 27% raportuan se punonin plotësisht nga shtëpia në maj 2020, vetëm 3% raportuan të njëjtën gjë në nëntor.

Figura 52 Ndryshimet në vendin (lokacionin) tipik të punës, vala 1 vs. vala 2



Pak më shumë gra deklaruan se dikur punonin jashtë shtëpive të tyre, por tani punojnë nga shtëpia me orar të plotë (6%) krahasuar me burrat (2%).


Figura 53 Ndryshimet në vendin (lokacionin) tipik të punës, sipas gjinisë



Rritja e konsiderueshme e ngarkesës së punës dhe nevoja për të përballuar shumë detyra njëkohësisht dallohen si sfida të përjetuara nga më shumë se gjysma e të anketuarve që punojnë në distancë (60% dhe


58% respektivisht). Cilësia e dobët e lidhjes në internet (47%) dhe mungesa e hapësirës për të rregulluar një zyrë në shtëpi (40%) duket se gjithashtu kanë qenë sfida të dukshme.

Figura 54 Sfidat e punës në distancë




Mostra e atyre që kanë punuar në distancë në këtë anketë është e vogël, prandaj rezultatet mbi gjininë interpretohen vetëm si indikative. Si burrat ashtu edhe gratë kanë një rritje të konsiderueshme të ngarkesës së punës, megjithëse 63% e burrave e raportojnë këtë si sfidë krahasuar me 58% të grave. Një numër mjaft i lartë i burrave (58%) konsideruan lidhjen e dobët në internet si problem ndërsa vetëm 32% e konsideruan këtë problem. Nga ana tjetër, më shumë gra (42%) shprehën se u mungon hapësira në dispozicion për të rregulluar zyrat në shtëpi sesa burrat (38%). Burrat (42%) gjithashtu duket se ndiheshin sikur përgjegjësitet e tyre të kujdesit brenda familjes paraqisnin një sfidë gjatë punës në distancë, shumë më tepër sesa për gratë (32%). Këto rezultate megjithëse indikative pasqyrojnë ndarjen e roleve gjinore në drejtim të përgjegjësisive dhe burimeve të disponueshme brenda një familjeje ose në punë që janë përjetësuar dhe janë ende të përhapura në shoqëri.

Figura 55 Sfidat e punës në distancë, sipas gjinisë




Ata të anketuar që kanë pasur ndryshime në vendin e tyre të punës dhe kanë punuar ose aktualisht punojnë nga shtëpia, u pyetën nëse do të preferonin të vazhdonin të punonin nga shtëpia edhe pas pandemisë. Mostra për këta njerëz është më pak se 50 të anketuar, kështu që rezultatet janë vetëm indikative. Përgjigjet ndaj kësaj pyetje ndryshonin me 28% që nuk dinin përgjigje për këtë pyetje, 37% nuk preferonin të vazhdonin të punonin nga shtëpia dhe 35% preferonin të vazhdonin të punonin nga shtëpia.

Figura 56 Preferenca në vazhdimin e punës nga shtëpia pas pandemisë




Më shumë gra (37%) sesa burra (33%) të cilët kanë punuar në distancë gjatë pandemisë preferuan të vazhdojnë të punojnë nga shtëpia edhe pas pandemisë. Për sa i përket statusit civil, personat e martuar (46%) dëshirojnë të vazhdojnë të punojnë nga shtëpia pas pandemisë dukshëm më shumë sesa beqarët (20%). Në varësi të llojit të punës, të martuarit mund të ndjehen sikur mund të menaxhojnë më mirë me punën dhe detyrat e shtëpisë kur janë në shtëpi sesa në zyrë. (Ju lutemi vini re se rezultatet e treguara në këtë grafik janë vetëm indikative për shkak të numrit të vogël të rasteve).

Figura 57 Preferenca në vazhdimin e punës nga shtëpia pas pandemisë, sipas gjinisë dhe statusit civil



Pagesa joformale në kesh për pagesën e pagave të punonjësve është ende një dukuri e zakonshme në Kosovë. Rezultatet zbuluan se dy të tretat e të anketuarve pohuan se merrnin pagën e tyre përmes një llogarie bankare (68%), ndërsa gati një e treta deklaroi se e merrnin pagën në kesh (në para të gatshme) (30%). Pagesa joformale duket të jetë shumë më e zakonshme në sektorin privat ku 46% thanë se e morën pagën e tyre në kesh. Në sektorin publik pagesa në kesh ishte raportuar vetëm nga 2% e të anketuarve.


Figura 58 Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas sektorit



Pothuajse dy në pesë burra (36%) dhe një në pesë gra (20%) marrin pagat e tyre në kesh. Rreth 79% e grave dhe 62% e burrave marrin pagat e tyre përmes një llogarie bankare, dhe 1% e secilës marrin një pjesë të pagave të tyre në kesh dhe një pjesë përmes një llogarie bankare. Mënyra e marrjes së pagës mund të shpjegojë faktin se një numër i konsiderueshëm i njerëzve në Kosovë mendohet se punojnë pa kontrata duke e bërë kështu punën e tyre të pasigurt. Burrat duket se janë më të ndjeshëm ndaj kësaj sesa gratë; edhe pse,


ata janë më të punësuar në përgjithësi dhe më shumë prej tyre punojnë në aktivitete më pak të rregulluara të biznesit sesa gratë (p.sh., ndërtimi dhe prodhimi kundrejt arsimit dhe tregtisë).<sup>8</sup>

Figura 59 Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas gjinisë



Për më tepër, ndërsa një në tre të anketuar shqiptarë deklarojnë se kanë marrë pagën e tyre në kesh para pandemisë (33%), vetëm 11% e të anketuarve serbë deklarojnë të njëjtën gjë.

Figura 60 Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas përkatësisë etnike




<sup>8</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Punësimi sipas industrisë dhe gjinisë.

[https://askdata.rks.gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdata\\_Labour%20market\\_02%20Annual%20labour%20market\\_Pun%c3%absimi/lfs05.px/Tabela/TabelaViewLayout1/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/](https://askdata.rks.gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdata_Labour%20market_02%20Annual%20labour%20market_Pun%c3%absimi/lfs05.px/Tabela/TabelaViewLayout1/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/) Last accessed on: 23.12.2020


Sipas ligjit në Kosovë, punëdhënësit janë të detyruar të paguajnë kontribute pensionale për të gjithë punonjësit e tyre me 5% të pagës së tyre bruto në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Sidoqoftë, vetëm 73% e të anketuarve deklaruan se punëdhënësit e tyre ua kanë paguar kontributet pensionale para pandemisë. Duhet të theksohet se pothuajse të gjithë të punësuarit në sektorin publik deklaruan se punëdhënësit e tyre ua paguajnë kontributet (98%), ndërsa vetëm 60% e të punësuarve në sektorin privat deklaruan të njëjtën gjë.

Figura 61 Pagesa e kontributeve pensionale para COVID-19, sipas sektorit




Punëdhënësit e të anketuarve që banojnë në zonat urbane ua paguanin kontributet pensionale në numër më të lartë para pandemisë (80%) sesa të atyre të punësuar në zonat rurale (67%).

Figura 62 Pagesa e kontributeve pensionale para COVID-19, sipas zonës së banimit




Të dhënat gjithashtu treguan se punëdhënësit e të anketuarve serbë paguajnë më shpesh kontribute pensionale (89%) sesa punëdhënësit të anketuarve shqiptarë (71%).

Figura 63 Pagesa e kontributeve pensionale para COVID-19, sipas përkatësisë etnike




Në fund, më shumë gra të punësuar (83%) sesa burra (73%) deklarojnë se punëdhënësi i tyre paguan kontribute pensionale për to, gjë që mund të tregojë një nivel më të lartë të punësimit formal për gratë sesa burrat.

Figura 64 Pagesa e kontributeve pensionale para COVID-19, sipas gjinisë



Rezultatet e të dhënave sugjerojnë gjithashtu që shumica e punëdhënësve kanë marrë masa parandaluese për të ndaluar përhapjen e COVID-19 në vendet e punës. Mesatarisht, niveli i pajtimit i të të anketuarve lidhur me atë nëse punëdhënësit e tyre kanë marrë masa parandaluese ishte 4.1 pikë nga 5.0 pikë.


Figura 65 Niveli i pajtimit me deklaratën "Punëdhënësi im ka marrë masa parandaluese për të ndaluar përhapjen e COVID-19 në vendin tim të punës"



Shumica e të anketuarve deklaruan se janë aktualisht të punësuar (51%). Kur analizohen të dhënat për punësimin aktual të ndara sipas statusit të punësimit përpara përhapjes së COVID-19, bëhet e qartë se ata që punonin për një person, kompani ose institucion ose ishin të vetëpunësuar kishin më shumë gjasa të ishin akoma të punësuar (86% dhe 84% përkatësisht). Ata që ishin të papunë para COVID-19, kryesisht mbetën pa punë (98% e atyre që nuk kërkonin punë dhe 89% e atyre që kërkonin punë).




Figura 66 Punësimi aktual, sipas statusit të punësimit para përhapjes së COVID-19




Shumica e të anketuarve të cilët deklaruan se janë aktualisht të punësuar ishin po ashtu të punësuar para pandemisë dhe mbetën duke punuar në të njëjtin sektor si më parë (87%). Rreth 11% (privat) dhe 1% (publik) ose kanë gjetur punë të re ose kanë ndryshuar sektorin e tyre të punës krahasuar me atë të para pandemisë.

Figura 67 Sektori aktual i punësimit



Të anketuarit që kanë ndryshuar sektorin e tyre të punës ende kryesisht punojnë brenda të njëjtit aktivitet biznesi (56%) si para pandemisë, ndërsa 10% tani punojnë në arsim/shëndetësi, 6% brenda aktiviteteve të biznesit në lidhje me mikpritjen dhe 5% në tregti me pakicë.

Figura 68 Punësimi aktual sipas aktiviteteve të biznesit



Të anketuarit që ishin të punësuar (ose të paktën kishin një anëtar të familjes i cili ishte i punësuar), deklaruan në 54% të rasteve se nuk janë fituesi kryesor i të ardhurave në familjen e tyre. Gjatë valës 1 të vlerësimit, doli se 10% deklaruan se nuk kishin asnjë anëtar të familjes që ishte i angazhuar me punë, ndërsa rezultatet që i përkisnin valës 2 tregojnë se asnjë i anketuar nuk ishte pjesë e një familjeje pa ndonjë angazhim pune. Burrat dukshëm kishin më shumë gjasa të ishin fituesit kryesorë të familjes (71%) sesa gratë (20%).

Figura 69 Të anketuarit që janë fituesit kryesorë të të ardhurave






Figura 70 Të anketuarit që janë fituesit kryesorë të të ardhurave, sipas gjinisë




Nga ato familje ku fituesi kryesor i të ardhurave nuk ishte i anketuari, aktiviteti i biznesit të punësimit të fituesve kryesorë të të ardhurave më së shpeshti ka qenë në ndërtimtari (17%), sektor publik (13%), restorant, kafene ose hotel (11%), arsim dhe shëndetësi si dhe industri/prodhim (nga 10%). Një pjesë më e vogël e fituesve kryesorë të të ardhurave ishin të punësuar në tekstil/veshmbathje (0.3%) dhe pasuri të paluajtshme (0.4%).

Figura 71 Punësimi sipas aktiviteteve të biznesit i fituesit kryesor të të ardhurave



Kur vlerësohet ndikimi në orët e paguara të punës për fituesin kryesor të të ardhurave në familje, rezultatet treguan se shumica nuk raportuan asnjë ndryshim në këtë drejtim (55%). Sidoqoftë, një në katër raportoi një ulje në orët e paguara të punës të fituesit kryesor të të ardhurave (25%). Mos ndryshimi në orët e paguara të punës ishte më i zakonshëm në sektorin publik (65%), sesa në sektorin privat (50%).


Figura 72 Ndikimi në orët e paguara të punës të fituesit kryesor të të ardhurave të familjes nga COVID-19



Ekzistojnë disa dallime midis ndryshimit në orët e paguara të burrave dhe grave. Rreth 6% e grave dhe 5% e burrave deklaruan se kanë rritur orët e punës. Gjashtë përqind e grave dhe 9% e burrave nuk deklarojnë asnjë ndryshim në orët e punës, por megjithatë një rënie në pagë. Rreth një e pesta grua (18%) dhe një i


pesti burra (20%) punojnë më pak orë pas pandemisë, por nuk kanë humbur punën. Ndërsa më shumë gra (13%) sesa burrat (11%) humbën punën e tyre.

Figura 73 Ndikimi në orët e paguara të punës nga COVID-19, sipas gjinisë




COVID-19 ka ndikuar në punësimin si dhe në gjendjen financiare të shumë njerëzve. Kështu, matja e ndikimit të pandemisë në burimet personale të të ardhurave të anketuarve jep një pasqyrë të rëndësishme mbi nivelin e ndikimeve të tilla. Të ardhurat nga punët e paguara, si dhe të ardhurat nga bizneset vetanake/bizneset familjare/puna e pavarur (freelance) u dalluan me numrin më të lartë të rasteve ku të ardhurat kanë rënë (16% dhe 13% përkatësisht) Paratë ose gjërat e marra nga jashtë janë rritur me 9%, gjithashtu edhe mbështetja e marrë nga institucionet e Kosovës (5%) është rritur.

Figura 74 Efektet e COVID-19 në burimet personale të të ardhurave




Në të dy valët e anketës, të anketuarit kishin përvoja të ngjashme në të ardhurat e marra nga mjete të ndryshme. Njerëzit që kanë bujqësinë si një nga burimet e të ardhurave përjetuan 5% dhe 6% rënie në maj dhe nëntor. Të ardhurat e të anketuarve nga bizneset ishin ulur më shumë gjatë valës 1 (24%) sesa gjatë valës 2 (18%). I njëjti trend vlen për të ardhurat nga një vend pune ku në valën 1, 29% e njerëzve përjetuan një rënie në pagë, dhe vetëm 18% e njerëzve e përjetuan atë gjatë valës 2. Megjithatë, megjithëse në sasi të vogla, më shumë njerëz gjatë valës 1 (6 %) sesa gjatë valës 2 (5%) deklaruan një rënie në të ardhurat nga pronat, investimet ose kursimet. Ndërsa, pensionet ose pagesat e tjera sociale, u rritën për 2% të të anketuarve në secilën valë dhe nuk kishin asnjë ndryshim për 6% dhe 10% të tyre (vala 1 dhe vala 2), por nuk pësuan një rënie në asnjërën (shih figurën më poshtë).

Figura 75 Efektet e COVID-19 në burimet personale të të ardhurave, vala 1 vs. vala 2



Nga ata të anketuar që raportuan se kanë humbur punën e tyre, vetëm 9% dhe 8% përkatësisht raportojnë se kanë marrë mbështetje financiare ose përfitime të papunësisë nga institucionet e Kosovës. Disa shpeshojnë të marrin përfitimet e përmendura në të ardhmen (përkatësisht 10% dhe 12%). Rreth 9% gjithashtu presin të marrin përfitime nga papunësia ose mbështetje financiare nga komuna në të ardhmen.


Figura 76 Të anketuarit që morën përfitime nga papunësia dhe /ose ndonjë mbështetje financiare që nga përhapja e COVID-19



\*Vetëm ata që kanë humbur punën

Shumica e të anketuarve nuk kanë marrë ndonjë mbështetje në të mira materiale nga institucionet e Kosovës (99%), komunit (96%) apo OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare (97%). Shumë pak morën ushqim nga komunit (3%) ose OJQ-të (2%). Pothuajse asnjë nga të anketuarit nuk ka marrë pajisje higjienike personale ose familjare. Të dhënat pasqyrojnë ato të valës 1 që do të thotë se programet e nivelit qendror dhe komunal nuk kanë arritur shumicën e njerëzve.


Figura 77 Të anketuarit që kanë marrë mbështetje në të mira materiale që nga përhapja e COVID-19



Pothuajse tre në katër të anketuar ulën shpenzimet për aktivitete të kohës së lirë, mallra jo-thelbësore dhe argëtim në mënyrë që të kompensojnë humbjen e të ardhurave ose në përgatitje të humbjes së mundshme të të ardhurave (70%). Pothuajse gjysma duhej të përdorte kursimet (49%) ndërsa 41% raportuan të mbështeteshin në ushqime më pak të preferuara ose më të lira për t'iu kundërvënë humbjes (e mundshme) së të ardhurave. Është shqetësuese se përkatësisht 23% dhe 17% e të anketuarve gjithashtu deklaruan se kanë ulur shpenzimet për çështjet e arsimit dhe shëndetësisë.

Rreth 15% huazuan para nga familja ose miqtë për të përballuar situatën, ndërsa 8% shisnin mallra shtëpiake të qëndrueshme. Vetëm 6% huazuan para nga institucionet financiare.


**Figura 78 Kompensimet e ndërmarra për humbjen e të ardhurave/humbjen e mundshme të të ardhurave nga familjet që nga fillimi i COVID-19**





Në përgjithësi, nga të gjithë njerëzit që kanë përjetuar vështirësi të mëdha në qasjen në shërbimet shëndetësore, 22% ulën shpenzimet për shëndetin. Rreth 24% e atyre që përjetojnë disa vështirësi në qasjen në shërbimet shëndetësore, ulën shpenzimet e tyre shëndetësore. Vetëm 12% e atyre që nuk kanë vështirësi kanë zvogëluar shpenzimet e tyre shëndetësore. Rreth 21% e atyre që nuk kishin nevojë për shërbime shëndetësore zvogëluar shpenzimet shëndetësore.

Figura 79 Qasja në shëndet dhe zvogëlimi i shpenzimeve shëndetësore




### 3.1.5 Ndarja e punëve të shtëpisë dhe dinamika shoqërore

COVID-19 po paraqet sfida dhe ndikime të gjera mbi njerëzit jo vetëm në lidhje me çështjet financiare dhe të punësimit. Shpërndarja e punëve shtëpiake dhe dinamikave sociale brenda familjeve preken gjithashtu.

Në përgjithësi, rritja e orëve të përkushtuara për mbështetjen emocionale për anëtarët e rritur të familjes u dallua me pjesën më të lartë të të anketuarve duke përmendur një rritje në këtë aktivitet (37%). Kjo është ndjekur nga 18% që raportuan një rritje të orëve të kaluara në pastrimin dhe mirëmbajtjen e banesave të tyre dhe 15% që i kanë kushtuar më shumë kohë blerjeve për familjen e tyre.

Rreth 12% raportuan një rritje të orëve të kushtuara për të kaluar kohën me fëmijët e tyre si në gatimin dhe shërbimin e shujtave dhe menaxhimin e shtëpisë.


Figura 80 Ndryshimet në orët e kushtuara aktiviteteve si rezultat i COVID-19



Më pak të anketuar deklarojnë se kanë rritur orët e përkushtuara për aktivitetet brenda familjes dhe për anëtarët e familjes në nëntor sesa në maj. Krahasuar me valën 1 (46%), më pak njerëz kanë një mbështetje të rritur emocionale për anëtarët e rritur të familjes që nga nëntori në valën 2 (37%). Në mënyrë të ngjashme, në maj, pothuajse gjysma e të anketuarve (48%) kanë thënë se kanë kaluar më shumë kohë në pastrimin


dhe mirëmbajtjen e shtëpisë së tyre dhe rreth 18% thanë të njëjtën gjë në nëntor. Ngarkesa e shtuar me të gjitha aktivitetet është shumë më e vogël në valën 2 sesa valën 1. Këtu përfshihen: blerjet (36% vala 1, 15% vala 2), loja ose aktivitete të tjera me fëmijë (33% vala 1, 14% vala 2), udhëzimi, mësimi ose trajnimi i fëmijëve (32% vala 1, 12% vala 2), madje edhe gatimi dhe shërbimi i shujtave (42% vala 1, 12% vala 2).

Figura 81 Ndryshimet në orët e kushtuara aktiviteteve si rezultat i COVID-19, vala 1 vs. vala 2 (1/2)



E njëjta gjë vlen për aktivitetet në figurën më poshtë. Më shumë orë për menaxhimin e shtëpisë (23% vala 1, 12% vala 2), për kujdesin për fëmijët, ushqimin, pastrimin ose sigurimin e kujdesit tjetër fizik (27% vala 1, 8% vala 2), apo edhe për pjesëmarrjen në aktivitete bujqësore (12% vala 1, 6% vala 2) janë kushtuar nga më pak njerëz në valën 2 krahasuar me valën 1. Këto të dhëna pasqyrojnë situatën në Kosovë se në nëntor ishte masa shumë më të lirshme kufizuese sesa nga marsi deri në maj të vitit 2020 për shkak të pandemisë COVID-19.

Figura 82 Ndryshimet në orët e kushtuara aktiviteve si rezultat i COVID-19, vala 1 vs. vala 2 (2/2)



Kur hedhim një vështrim më të afërt të ndryshimeve në orë të kushtuara për aktivitete të caktuara, të ndara sipas gjinisë, të dhënat zbuluan se gratë kishin më shumë të ngjarë të kishin kaluar më shumë orë në pastrim (24%) dhe gatim (18%) sesa burrat (13% dhe 6%) përkatësisht). Gjithashtu ra në sy se një numër i konsiderueshëm i burrave deklaruan se zakonisht nuk merren me gatim (58%) ose pastrim (35%) fare.

Nga ana tjetër, më shumë burra raportuan se kishin kaluar kohë të shtuar në blerje për familjen (19%), menaxhim shtëpie (16%) duke luajtur me fëmijët e tyre (16%) dhe mësuar apo trajnuar fëmijët e tyre (15%) sesa gratë (10%).<sup>9</sup>

<sup>9</sup> Përqindjet e zgjedhjeve 'nuk është e aplikueshme' përfshijnë njerëz për të cilët disa nga opsionet nuk aplikohen, për shembull, për individët pa fëmijë ose partnerë, kujdesi për anëtarët e familjes dhe opsionet e kujdesit ndaj fëmijëve nuk aplikohen.

Figura 83 Ndryshimet në orët e kushtuara aktiviteve si rezultat i COVID-19, sipas gjinisë (1/2)





Figura 84 Ndryshimet në orët e kushtuara aktiviteve si rezultat i COVID-19, sipas gjinisë (2/2)




\*radhitur sipas 'është rritur'

Rolet dhe përgjegjësitë brenda familjeve gjithashtu janë prekur. Në përgjithësi, ajo që u dallua si pozitive ishte se anëtarët e tjerë të familjes, partnerët, djemtë dhe vajzat duket se i kanë ndihmuar të anketuarit më shumë që nga fillimi i pandemisë.

Megjithatë, duhet të theksohet se burrat deklaruan se kishin marrë veçanërisht më shumë mbështetje nga anëtarët e tjerë sesa gratë. Për shembull, përdorisa pothuajse dy në tre burra raportuan se partnerja e tyre ndihmonte më shumë në punët e shtëpisë (63%), vetëm 36% e grave raportuan të njëjtën gjë.

Figura 85 Efektet e COVID-19 në rolet dhe përgjegjësitë brenda familjes, sipas gjinisë




### 3.1.6 Qasja në shërbime bazike dhe Siguria

Pyetësi i anketës përfshinte pyetje të dedikuara për qasjen në shërbimet bazike dhe sigurinë në kohërat e pandemisë COVID-19. Anketa vlerëson nëse të anketuarit përjetuan efekte psikologjike ose fizike që burojnë nga stresi i muajve të fundit, nëse ata përballen me vështirësi në qasjen e shërbimeve të caktuara siç janë shërbimet shëndetësore dhe sociale ndër çështje të tjera.

Rezultatet krahasuese të të dhënave midis valës 1 dhe valës 2 tregojnë qartë se efektet psikologjike janë rritur; 36% deklaruan se shëndeti i tyre mendor ose emocional është prekur, krahasuar me vetëm 28% që deklaruan të njëjtën gjë në maj të vitit 2020. Rastet e sëmundjes fizike dhe sëmundjes së një anëtarit të familjes janë rritur gjithashtu me 11 pp dhe 9 pp përkatësisht. Rastet e migrimit të brendshëm dhe kthimit nga jashtë për shkak të COVID-19 kanë mbetur kryesisht të njëjtat kur krahasohen me valën 1. Rastet e vdekjes së një anëtarit të familjes tani qëndronin në 2% krahasuar me 1% gjatë valës 1.

Figura 86 Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ju personalisht ndonjë rën nga të mëposhtmet?, vala 1 vs. vala 2




Shfaqet vetëm kategoria që janë përgjigjur me 'po'



Rezultatet e të dhënave nga vala 2 treguan se si burrat ashtu edhe gratë ndjenin se shëndeti i tyre psikologjik, mendor ose emocional është prekur nga pandemia e COVID-19. Ngjashëm me rezultatet e valës 1, gratë duket se janë më të prekura në këtë drejtim (40%) sesa burrat (32%).

Sidoqoftë, më shumë burra raportuan gjithashtu efekte psikologjike tani në nëntor 2020 (32%) sesa në maj 2020 (25%), i cili paraqet një rritje prej 7 pp. Rritja e efekteve psikologjike të raportuara nga gratë arrin në 9 pp.

Figura 87 Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ju personalisht ndonjërin nga të mëposhtmet?, sipas gjinisë



Shfaqet vetëm kategoria që janë përgjigjur me 'po'

Të anketuarit më të vjetër mbi moshën 65 vjeç më shpesh raportuan sëmundje fizike (15%) sesa të anketuarit që i përkasin grupmoshave më të reja. Asnjë ndryshim të rëndësishëm mes grupmoshave nuk kishte sa i përket sëmundjeve ose vdekjes së një anëtari të familjes, si dhe sa i përket migrimit ose kthimit nga jashtë. Efektet në shëndetin mendor ose emocional ndryshonin pak në mes të anketuarve të moshave të ndryshme brenda vargut prej 11 pp. Të anketuarit mes moshës 55 dhe 64 vjeç si dhe ata mes 35 dhe 44 vjeç raportuan më shpesh efekte në shëndetin e tyre mendor ose emocional sesa të tjerët (42% dhe 38% përkatësisht).

Figura 88 Si pasojë e COVID-19, a ke ni përjetuar ju personalisht ndonjë rën nga të mëposhtmet?, sipas moshës (1/2)






Figura 89 Si pasojë e COVID-19, a ke ni përjetuar ju personalisht ndonjë rën nga të mëposhtmet?, sipas moshës (2/2)



Humbja e vendeve të punës mund të rrisë presionin për njerëzit veçanërisht gjatë një pandemie. Në të vërtetë, 49% e atyre që humbën punën që nga përhapja e COVID-19, deklaruan se shëndeti i tyre mendor dhe emocional ishte prekur.


Figura 90 Të anketuarit që humbën vendet e punës dhe deklaruan shëndetin mendor dhe emocional të prekur



Qasja në shërbimet bazike, sociale dhe shëndetësore, transportin publik dhe produktet themelore shëndetësore u hulumtua gjithashtu në këtë anketë. Në përgjithësi, mund të vërehet se vështirësitë në qasjen e shërbimeve bazike janë ulur ndjeshëm kur krahasohen rezultatet nga vala 1 dhe 2. Këto vështirësi ishin më të prira gjatë valës 1 për shkak të masave më të ashpra kufizuese në maj 2020 krahasuar me ato të nëntorit 2020.


Sidoqoftë është e rëndësishme të theksohet se disa vështirësi duket se vazhdojnë. Të anketuarit raportuan disa vështirësi ose vështirësi të mëdha në lidhje me qasjen në produktet ushqimore (26% së bashku), pajisjet personale mbrojtëse (PPM) (24% së bashku) dhe shërbimet shëndetësore (24% së bashku). 15% të tjerë raportuan disa ose vështirësi të mëdha në qasjen e produkteve higjienike/sanitare, dhe 14% përballeshin me disa vështirësi në lidhje me qasjen në transportin publik.

Figura 91 Përvoja personale me vështirësi në qasjen në shërbime bazike, vala 1 vs. vala 2




Rezultatet e ndara sipas gjinisë zbuluan se më shumë burra kishin vështirësi të mëdha ose disa me qasjen në shërbimet shëndetësore (27%) sesa gratë (21%). Më shumë burra gjithashtu raportuan vështirësi të mëdha ose disa në qasjen e produkteve higjienike dhe sanitare si dhe PPM (18% dhe 27% përkatësisht) sesa gratë (përkatësisht 13% dhe 20%). Nuk u vërejtën ndryshime domethënëse në lidhje me qasjen në llojet e tjera të shërbimeve.

Figura 92 Përvoja personale me vështirësi në qasjen në shërbime bazike, sipas gjinisë



Kur vlerësohet qasja në shërbimet themelore në nëntor 2020 sipas rajoneve të ndryshme, disa rezultate të të dhënave dalloheshin. Në rajonin e Gjakovës, të anketuarit raportuan vështirësi në një farë mase me qasjen në produkte ushqimore (42%), shërbime shëndetësore (41%), shërbime sociale (37%) dhe furnizime mjekësore (36%). Në Mitrovicë u raportuan vështirësi në qasje për produktet ushqimore dhe produkte mjekësore (përkatësisht 31% dhe 30%), në Prishtinë gjithashtu në lidhje me dy të sapo përmendurat (24% secila) dhe në Prizren doli se 24 % raportuan vështirësi në qasjen në shërbimet sociale.


Figura 93 Përvoja personale me vështirësi në qasjen në shërbime bazike, sipas rajonit



Të anketuarit që banonin në zonat rurale ishin pak më të prirur për të raportuar vështirësi të mëdha ose disa më shërbime komunale (6%) krahasuar me ata që banonin në zonat urbane (3%), e njëjta gjë vlen për shërbimet sociale (16% rurale vs. 12% urbane), dhe transporti publik (17% vs. 11%). Në anën tjetër, më shumë të anketuar urbanë raportuan vështirësi të mëdha ose disa me qasjen në shërbimet shëndetësore (27%) krahasuar me at a që banojnë në zonat rurale (23%).


Asnjë ndryshim i dukshëm nuk u vërejt në lidhje me qasjen në produktet higjienike dhe sanitare, produktet ushqimore dhe PPM kur analizoheshin të dhënat e ndara sipas zonës së banimit.

Figura 94 Përvoja personale me vështirësi në qasjen në shërbime bazike, sipas zonës së banimit



Kërkesat për favore ose ryshfet në këmbim të qasjes në shërbimet themelore si rezultat i situatës me COVID-19 duket të ishin të rralla, megjithatë, jo të pa ekzistuar. Nga rreth 4% për secilën raportuan se ua është kërkuar ryshfet ose favore në këmbim të qasjes në pajisje mbrojtëse mjekësore dhe shërbime shëndetësore, si dhe transportin publik. Nga tre përqind raportuan një incident të tillë në lidhje me qasjen në produktet ushqimore, produktet sanitare ose shërbimet sociale.<sup>10</sup>

Figura 95 Përvoja personale me kërkesa për favore ose ryshfet në këmbim të qasjes në shërbimet themelore




<sup>10</sup> Kjo pyetje u shtua në pyetësin e anketës së valës 2.

Rritja e dhunës në familje që nga përhapja e COVID-19 është vërejtur në shumë vende të botës. Kohët e fundit, Policia e Kosovës publikoi rastet e dhunës në familje të raportuara ndërmjet janarit dhe shtatorit 2020. Numri i rasteve të raportuara arriti në 1,571, rreth 144 raste më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019.<sup>11</sup>

Rreth 59% e të anketuarve që morën pjesë në valën e dytë të këtij vlerësimi menduan se dhuna në familje është rritur që nga fillimi i pandemisë. Kjo paraqet një rritje të lehtë me tre pikë përqindje krahasuar me perceptimet në maj 2020 gjatë valës së parë të SEIA.

Figura 96 Perceptimi për rritjen e dhunës në familje që nga përhapja e COVID-19, vala 1 vs. vala 2




Perceptimi i rritjes së dhunës në familje ishte veçanërisht i lartë në Gjakovë dhe Mitrovicë (73% dhe 72% përkatësisht) e ndjekur nga të anketuarit që banojnë në Prishtinë (61%) dhe Gjilan (65%).

<sup>11</sup> Balkan Insight, Nëntor 2020, <https://balkaninsight.com/2020/11/25/women-of-southeast-central-europe-protest-rise-in-male-violence/> Qasur më 08.12.2020  
Policia e Kosovës. Përgjigje me email ndaj kërkesës zyrtare nga IDRA.




Figura 97 Perceptimi për rritjen e dhunës në familje që nga përhapja e COVID-19, sipas rajonit



Për më tepër, duhet të theksohet se më shumë se dy në tre serbë të intervistuar ndjejnë se dhuna në familje është rritur që nga fillimi i pandemisë (67%), ndërsa një e treta nuk dinte përgjigje për këtë pyetje.


Të dhënat gjithashtu treguan se të anketuarit që banonin në zonat urbane dhe gratë kishin më shumë gjasa të besonin se dhuna në familje është rritur (64% dhe 63% përkatësisht).

Figura 98 Perceptimi për rritjen e dhunës në familje që nga përhapja e COVID-19, sipas zonës së banimit, gjinisë dhe përkatësisë etnike




Në një shënim pozitiv, më shumë të anketuar raportuan se dinë se ku të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje në rast të dhunës në familje në nëntor 2020 (70%) sesa gjatë valës së parë të vlerësimit në maj 2020 (64%). Sidoqoftë, mbetet shqetësuese që gati një e treta nuk dinte se ku të kërkonte ndihmë në raste të tilla (30%).

Figura 99 Njohuri se ku mund të kërkohet ndihmë dhe mbështetje në rast se dikush përjeton dhunë në familje të tilla si linja telefonike, mbështetje psikologjike dhe policore, vala 1 vs. vala 2



Të anketuarit serbë duket se janë më të informuar (87%) sesa të anketuarit shqiptarë (69%) në lidhje me atë se ku mund të kërkohet ndihmë dhe mbështetje kur ndodh dhuna në familje. Interesante se përdherisa 63% e grave besonin se dhuna në familje është rritur (grafiku më lart), gati një në tre prej tyre deklaroi se nuk dinte se ku të kërkonte ndihmë dhe mbështetje në rast të përjetimit të dhunës në familje (32%).

Figura 100 Njohuri se ku mund të kërkohet ndihmë dhe mbështetje në rast se dikush përjeton dhunë në familje të tilla si linja telefonike, mbështetje psikologjike dhe policore, sipas zonës së banimit, gjinisë dhe përkatësisë etnike




### 3.1.7 Shëndeti seksual dhe riprodhues

Të anketuarit u pyetën nëse ata personalisht përjetuan vështirësi në qasjen në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, si dhe në kontraktivë për veten e tyre, partnerin e tyre ose anëtarët e tjerë të familjes.

Të dhënat treguan se shumica dërrmuese nuk kishin nevojë për qasje në shërbimet seksuale dhe riprodhuese. Ata që u përgjigjën pozitivisht nuk raportuan ndonjë vështirësi kur përpiqeshin të qasnin ndonjë nga shërbimet e radhitura. Rreth 4% dhe 2% raportuan disa vështirësi në qasjen e shërbimeve gjinekologjike ose shërbimeve shëndetësore të nënave, përkatësisht.

Figura 101 Që nga përhapja e COVID19, a keni përjetuar personalisht vështirësi në qasjen në shërbimet e mëposhtme të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe kontraktivë për vetveten, partnerin tuaj ose anëtar tjetër të familjes?



## 3.2. Anketa me ndërmarrje

Kjo pjesë e raportit paraqet rezultatet e të dhënave nga vala e dytë e anketës me ndërmarrje me 601 ndërmarrje në Kosovë. Rezultatet e të dhënave krahasohen me valën 1, aty ku është e zbatueshme. Ky kapitull është i ndarë në nën-seksione bazuar në pyetësinin i cili është përdorur për të kryer studimin.

### 3.2.1 Profili i ndërmarrjeve

Në përputhje me shtrirjen e bizneseve në Kosovë, rreth një e treta e bizneseve që morën pjesë në studim janë të vendosura në rajonin e Prishtinës (36%), ndërsa 16% janë të vendosura në rajonin e Prizrenit dhe 13% janë të vendosura në rajonin Gjakovës. Rreth 5% deri në 10% ishin në rajone të tjera. Për analizë domethënëse të të dhënave, ndarja sipas rajoneve ndahet në biznese me bazë në "Prishtinë" dhe "Jo-Prishtinë". Rreth 55% të ndërmarrjeve janë mikro (1-9 punonjës), 33% janë të vogla (10-49 punonjës) dhe 12% i përkasin kategorisë së mesme dhe të madhe (50+ punonjës).

Statusi ligjor i shumicës së bizneseve që morën pjesë në këtë studim ishte biznes individual (63%), ndërsa 31% u kategorizuan si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Shumica operojnë në treg prej më shumë se pesë vjet (74%), ndërsa 26% operonin në treg prej një deri në pesë vjet.

Figura 102. Shpërndarja rajonale e ndërmarrjeve




Figura 103. Madhësia e ndërmarrjes




Figura 104. Statusi ligjor i ndërmarrjeve





Figura 105. Vitet në treg



Sektorët e biznesit më të përfaqësuar në këtë vlerësim ishin tregtia me pakicë (22%), industria/ prodhimi (18%) dhe ndërtimtaria (14%). Shumica dërmuese e ndërmarrjeve nuk eksportojnë mallra dhe shërbime (77%).

Figura 106. Ndarja e ndërmarrjeve sipas sektorit





Figura 107. Ndërmarrjet eksportuese




### 3.2.2 Ndikimi i COVID-19 në ndërmarrje

Pjesa e parë e anketës me ndërmarrje eksploron ndikimin që pati pandemia COVID-19 mbi ndërmarrjet. Po ashtu vlerëson shkallën e ndikimeve dhe e krahason me gjetjet e anketës së SEIA-s së parë të kryer në maj 2020, aty ku është e zbatueshme.

Shumica e ndërmarrjeve të anketuara ishin në pronësi të burrave (82%). Vetëm 11% e ndërmarrjeve ishin në pronësi të grave. Ndërsa, 8% e ndërmarrjeve kishin disa pronarë.

Figura 108 Gjinia e pronarëve të kompanisë




Shumica e ndërmarrjeve të anketuara raportuan se performanca e tyre financiare para pandemisë COVID-19 kishte qenë e mirë ose shumë e mirë (65% së bashku). Në anën tjetër, rreth 22% deklaruan një performancë financiare shumë të dobët ose të dobët.

Rezultatet e të dhënave treguan se ato ndërmarrje të vendosura në rajone të tjera përveç Prishtinës kishin dukshëm më shumë gjasa të kishin performuar dobët ose shumë dobët para fillimit të pandemisë (34% së bashku).




Figura 109. Performanca financiare e ndërmarrjeve para COVID-19




Interneti dhe rrjetet sociale mbetën burimet më të përdorura për rreth dy të tretat e për të anketuarit e ndërmarrjeve (67%) kur marrin informacione lidhur me COVID-19. Më pak të anketuar ndërmarrjesh deklaruan gjatë valës 2 të kenë përdorur radio, televizion dhe gazeta (25%) sesa gjatë valës 1 (33%). Përdorimi i uebfaqeve zyrtare të qeverisë, njoftimet publike dhe aplikacionet e telefonit mbeti i vogël gjatë kësaj vale mes bizneseve.

Figura 110 Burimet kryesore të informacionit në lidhje me COVID-19 (rreziqet, veprimet parandaluese të rekomanduara, strategjitë e përballimit), vala 1 vs. vala 2




Mbështetja për masat kufizuese për të mbyllur ose kufizuar aktivitetin e biznesit ka rënë ndjeshëm. Në maj të vitit 2020, mbi gjysma e të anketuarve nga ndërmarrjet deklaruan se mbështetnin deri diku (44%) ose fuqishëm (16%) masat. Kjo është e kundërta e të dhënave të nëntorit të vitit 2020 ku vetëm 21% mbështetën deri diku dhe 6% mbështetën fuqimisht masat. Kundërshtimi i fuqishëm ndaj masave në fjalë është rritur me 30 pikë përqindje (pp) nga 8% në 38%. Disa arsye për këtë mund të lidhen me vonesën e ndihmës së institucioneve të Kosovës ndaj ndërmarrjeve; miratimi i vonuar i Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike; dhe mosbesimi në institucionet e Kosovës si një aleat. Për më tepër, elementi kohor mund të jetë një arsye këtu pasi që mbyllja për nëntë muaj në krahasim me tre muaj plotësisht ose pjesërisht ka më shumë efekte negative.

Figura 111 Mbështetja për masat aktuale të qeverisë për të mbyllur/kufizuar veprimtarinë e bizneseve në mënyrë që të ngadalësohet përhapja e COVID-19, vala 1 vs. vala 2




Rezultatet e të dhënave më tej treguan se sa më e vogël të jetë ndërmarrja në madhësi, aq më shumë ato kundërshtojnë masat kufizuese. Përderisa 59% e ndërmarrjeve mikro ishin kundër masave, 44% e ndërmarrjeve të vogla dhe vetëm 31% e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha ishin kundër tyre (kundërshtimi deri diku dhe i fuqishëm së bashku).

Figura 112. Niveli i mbështetjes për masat aktuale të qeverisë për të mbyllur/kufizuar veprimtarinë e bizneseve në mënyrë që të ngadalësohet përhapja e COVID-19, sipas madhësisë së ndërmarrjes



Anketa gjithashtu mati ndikimin e përgjithshëm që COVID-19 kishte në ndërmarrje deri më tani. Të dhënat treguan qartë se ndikimet negative janë rritur me kalimin e kohës. Në maj të vitit 2020, 23% deklaruan se ndikimi i pandemisë ka të ngjarë të jetë shumë negativ, ky numër u rrit në 55% në nëntor 2020, një rritje prej 32 pp. Në anën tjetër, 13% e ndërmarrjeve raportuan se nuk ishin ndikuar nga COVID-19 gjatë valës 1, dhe vetëm 7% e të gjitha ndërmarrjeve ende deklarojnë të mos jenë ndikuar nga pandemia gjatë valës 2.


Figura 113 Ndikimi i COVID-19 në biznese në përgjithësi, vala 1 vs. vala 2



Ndërmarrjet mikro duket të jenë goditur më së shumti nga pandemia dhe efektet e saj, gjë që mund të shpjegojë kundërshtimin e tyre të fortë ndaj masave kufizuese. Mbi gjysma (56%) e të anketuarve të mikro

ndërmarrjeve deklaruan se kishin përjetuar ndikim shumë negativ dhe 36% të tjerë deri diku negativ. Ndërsa ndikimet deri diku negative janë qartë të dukshme në të gjitha kategoritë e ndërmarrjeve, ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha dallohen pak më pak meqë 19% e tyre nuk raportuan asnjë ndikim.


Figura 114 Ndikimi i COVID-19 në biznese në përgjithësi, sipas madhësisë së ndërmarrjes



Ato ndërmarrje që deklaruan se COVID-19 kishte ndikim negativ ose shumë negativ në biznesin e tyre u pyetën për arsyet përkatëse për atë vlerësim.


Gati dy në pesë ndërmarrje deklaruan mungesën e klientëve (37%) si problemin kryesor që buron nga pandemia e COVID-19. Rreth 13% e tyre përmendën vendosjen e masave kufizuese për të parandaluar përhapjen e COVID-19 si një arsye. Një tjetër 12% dhe 11% përkatësisht deklaruan uljen e produktivitetit dhe nivelet e ulëta të shitjeve si arsye. Ndërmarrjet e vogla duket se kanë pësuar veçanërisht me një rënie të produktivitetit (27%) krahasuar me ndërmarrjet e mesme/të mëdha (23%) dhe ndërmarrjet mikro (11%). Ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha dallohen meqë më pak sosh i panë masat kufizuese si arsye për ndikim negativ (5%) kur krahasoheshin me ndërmarrje të vogla ose mikro (13% secila).

Figura 115 Arsyet e ndikimit shumë negativ dhe negativ, sipas madhësisë së biznesit



Ndërmarrjet të cilave u është dashur të ndalojnë aktivitetet e tyre të biznesit zakonisht përmendin masat kufizuese si arsyeja kryesore (44%), megjithatë, kjo paraqet një rënie të konsiderueshme të të anketuarve që përmendin këtë arsye (-37 pp) krahasuar me valën e mëparshme të SEIA. Gjatë valës së dytë të SEIA, mungesa e klientëve ose e kërkesës ishte arsyeja kryesore për shkak të cilës një në katër ndërmarrje ndaluan aktivitetin e tyre (25%). Në maj të vitit 2020 vetëm 11% e kishin përmendur këtë arsye. Ndërsa, megjithëse në maj ndërmarrjet ndërprejnë aktivitetin për shkak të humbjeve financiare, 16% e tyre përmendën këtë si arsyen kryesore për të pezulluar aktivitetin në nëntor 2020.<sup>12</sup>


Figura 116 Arsyeja kryesore për pezullimin e aktivitetit të biznesit, vala 1 vs. vala 2



Më shumë se dy të tretat e ndërmarrjeve të vogla deklaruan se kishin ndaluar aktivitetet e tyre për shkak të masave kufizuese (69%), krahasuar me 43% dhe 33% përkatësisht të ndërmarrjeve mikro dhe të mesme/të mëdha. Mungesa e klientëve ose e kërkesës ishte më shpesh një arsye për mbylljen e ndërmarrjeve të reja (37%) dhe të ndërmarrjeve të mesme/mëdha (33%).

<sup>12</sup> Ky opsion i përgjigjes iu shtua pyetësorit gjatë valës 2.

Figura 117 Arsyeja kryesore për pezullimin e aktivitetit të biznesit, sipas madhësisë së ndërmarrjes




Vetëm 28% e ndërmarrjeve të cilat plotësisht ose pjesërisht kishin pezulluar aktivitetin e tyre paguan pagat e plota për të gjithë punonjësit. Detyrimi i punonjësve për të marrë pushime të papaguara ndodhi në 11% të rasteve, ndërsa 7% deklaruan se kishin paguar paga të pjesshme për të gjithë punonjësit e tyre.

Në përgjithësi, 53% e të gjithë të anketuarve të ndërmarrjeve deklaruan se nuk i detyrojnë punonjësit të marrin pushim dhe se nuk paguajnë rroga të pjesshme ose të plota për të gjithë ose disa punonjës.




Figura 118 Zbatueshmëria e deklaratave në lidhje me periudhën maj - shtator 2020



Ndryshimet në masat e bllokimit dhe rihapja graduale e shoqërisë në qershor 2020 janë gjithashtu të dukshme në të dhënat e marra nga studimi i kësaj vale. Gjatë valës 1, mbi gjysma e ndërmarrjeve raportuan se aktiviteti i tyre i biznesit ishte ndalur plotësisht për shkak të situatës COVID-19, ndërsa në nëntor 2020, vetëm 13% raportuan të njëjtën gjë. Në të kundërtën, ndalimi i pjesshëm i aktiviteteve të biznesit u raportua më shpesh gjatë valës 2 (40%), sesa gjatë valës 1 (31%).


Figura 119 Ndalja e plotë ose e pjesshme e aktiviteteve të biznesit për shkak të COVID-19, vala 1 vs. vala 2



Ato ndërmarrje që pësuan një ndalje të plotë në aktivitetet e tyre (13%) u pyetën më pas për arsyet që e shkaktuan atë.

Mungesa e klientëve u dallua si arsye, me 84% që përmendën këtë çështje dhe 70% të cilët deklaruan se kjo ishte arsyeja kryesore e ndalimit të plotë të aktivitetit të biznesit. Një e treta tjetër përmendi vështirësitë me pagesat e pagave (33%), ndërsa nga 28% të ndërmarrjeve deklaruan vështirësi në përmbushjen e detyrimeve tatimore ose rritjen e kostove si arsye për mbylljen. Një tjetër 22% i tyre përmendën vështirësitë në lidhje me organizimin e aktiviteteve të punës, ndërsa 8% gjithashtu deklaruan se vështirësitë në lidhje me organizimin e aktiviteteve të punës ishin arsyeja kryesore për një ndalje të plotë në aktivitetin e tyre të biznesit.

Figura 120 Arsyet dhe arsyeja kryesore për mbylljen e plotë të aktiviteteve




Gjatë kësaj vale të dytë, anketa e ndërmarrjeve gjithashtu vlerësoi nëse të anketuarit besonin se pakot ardhshme të lehtësimit ekonomik për ndërmarrjet do të shpërndahen në mënyrë të drejtë.

Në përgjithësi, gjetjet sugjerojnë se mendimet ishin të ndryshme në lidhje me këtë çështje. Rreth 23% besuan se pakot e ndihmave ekonomike do të shpërndahen deri diku në mënyrë të drejtë, ndërsa gati po aq (22%) besuan se do të shpërndahen deri diku në mënyrë të padrejtë. 15% të tjerë menduan se shpërndarja ka mundësi të jetë e padrejtë, 14% u shprehën si neutral dhe 12% besuan se shpërndarja do të jetë plotësisht e drejtë.

Të anketuarit që i përkasin ndërmarrjeve më të mëdha dhe ato të vendosura jashtë rajonit të Prishtinës kishin më shumë gjasa të besonin se shpërndarja do të bëhet në një mënyrë të drejtë, sesa ata që u përkasin ndërmarrjeve më të vogla ose ato të vendosura brenda rajonit të Prishtinës.

Figura 121 Perceptimi nëse pakot e ardhshme të lehtësimeve ekonomike për biznese do të shpërndahen në mënyrë të drejtë, sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe rajonit




Mbi gjysma e të anketuarve të ndërmarrjeve besuan se do të ndodhin mashtrime dhe korrupsion në lidhje me pakot e ndihmave për ndërmarrjet (55%). Nga këto, disa besuan (15%) se një sjellje e tillë me shumë gjasë nuk do të sanksionohet, ndërsa një tjetër 15% ishte i bindur se patjetër që nuk do të ketë ndonjë sanksion si pasojë e kësaj çështjeje. Një në katër të anketuar (25%) që besuan se mashtrimi dhe korrupsioni ka mundësi të ndodhin, ishin më me shpresë se sanksionet do të zbatohen.

Vetëm 17% besuan se nuk do të ketë ndonjë mashtrim dhe korrupsion në lidhje me pakot e ndihmave për bizneset. Ndërmarrjet më të mëdha (48%) dhe ato të vendosura në Prishtinë (30%) kishin më shumë gjasa të besonin se mashtrimi dhe korrupsioni nuk do të ndodhin.


Ndërmarrjet mikro janë ato që besojnë se do të tentohet mashtrimi dhe korrupsioni në lidhje me pakot e ndihmave të cilat nuk do të sanksionohen ose ka shumë mundësi të mos sanksionohen (15% dhe 16% përkatësisht), krahasuar me 11% dhe 4% të ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha dhe 14% dhe 8% të ndërmarrjeve të vogla. Sa më të mëdha kompanitë, aq më shumë besim kanë ato ndaj institucioneve të Kosovës, ku 45% e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, 32% e ndërmarrjeve të vogla dhe vetëm 16% e ndërmarrjeve mikro besojnë se nuk do të ketë mashtrim dhe korrupsion.

Figura 122 Perceptimi nëse do të tentohet mashtrimi dhe korrupsioni në lidhje me pakot e ndihmave për bizneset, sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe rajonit




Shumica e ndërmarrjeve duket se kanë vazhduar të paguajnë kontribute pensionale për punonjësit e tyre si përpara fillimit të pandemisë (85%) në nëntor 2020. Një numër i përafërt i ndërmarrjeve (80%) deklaruan të njëjtën gjë në maj 2020.

Figura 123 Ndërmarrjet që vazhdojnë të paguajnë kontribute pensioni për punonjësit e tyre si më parë COVID-19, vala 1 vs. vala 2




Sidoqoftë, duhet të theksohet se 18% e ndërmarrjeve më të reja (me operim prej 1-5 vjet) dhe 9% e bizneseve me operim prej 1-5 vjet kanë paguar kontribute pensionale për punonjësit e tyre. Duke marrë parasysh madhësinë e ndërmarrjes, 15% e ndërmarrjeve mikro raportuan se kompania e tyre nuk vazhdoi të paguante kontribute pensionale sipas ligjit në Kosovë, ndërsa 9% e ndërmarrjeve të vogla dhe vetëm 3% e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha raportuan të njëjtën gjë.

Figura 124. Ndërmarrjet që vazhdojnë të paguajnë kontribute pensioni për punonjësit e tyre si më parë COVID - 19, sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe viteve në treg



Numri i punonjësve që dhanë dorëheqjen (të cilët ishin pjesë e ndërmarrjeve që duhej të ndalonin veprimtarinë) është rritur kur krahasohet me valën e parë të SEIA. Ndërsa në maj të vitit 2020 vetëm 3% raportuan se punonjësit dhanë dorëheqje nga puna e tyre, në nëntor 2020 kjo pjesë arriti në 30%. Arsyet më të zakonshme të dorëheqjeve ishin se ndërmarrja nuk ishte në gjendje të paguante pagat për punonjësit. (Rezultati vetëm tregues për shkak të numrit të vogël të rasteve).


Figura 125. Punonjësit që kanë dhënë dorëheqjen nga puna e tyre



Arsyeja	Vala 2: Nëntor '20 (N)	Vala 1: Maj '20 (N)
Ne nuk ishim në gjendje të paguam pagat e tyre	14	2
Ata nuk mund të punonin për shkak të detyrimeve familjare ose / dhe të kujdesit për fëmijët	2	
Të tjera	6	2
Total	22	4

Shumica dërmuese e të anketuarve të ndërmarrjeve deklaruan se, në kohën e intervistës, të gjithë punonjësit punonin në ambientet e ndërmarrjes (91%) në krahasim me disa që punonin nga shtëpia (6%) ose të gjithë që punonin nga shtëpia (3%). Krahasuar me valën 1, kjo tregon një rritje prej 9 pikë përqindjeje (pp) të atyre ndërmarrjeve ku të gjithë punonjësit po punonin në ambiente të punës dhe një rënie pasuese prej 9 pp të rasteve kur të gjithë punonjësit po punonin nga shtëpia.

Figura 126. Ndryshimi në vendin e punës për shkak të COVID-19, vala 1 vs. vala 2




Të dhënat krahasuese në mes valës 1 dhe 2 gjithashtu hedhin dritë mbi sfidat specifike dhe nëse ato përbënin një problem për ndërmarrjet në maj 2020 dhe nëntor 2020.

Mungesat e klientëve (89%), vështirësitë me pagesat e pagave (39%) dhe përmbushja e detyrimeve tatimore (33%) u dalluan si tre problemet kryesore aktuale për ndërmarrjet në nëntor 2020.

Shkalla e problemeve me të cilat merren ndërmarrjet e Kosovës për shkak të pandemisë së koronavirusit është rritur me kalimin e kohës. Në përgjithësi, mund të vërehet se numri i bizneseve që përballen me një sërë problemesh është rritur në valën 2, vlerësuar nëntë muaj pas shpërthimit të COVID-19 në krahasim me valën 1, vlerësuar tre muaj pas shpërthimit të COVID-19. Në të vërtetë, më shumë ndërmarrje raportuan se kishin probleme me mungesën e klientëve (89% vs. 75%), me pagesën e pagave (39% vs. 19%) dhe me përmbushjen e detyrimeve tatimore (33% vs. 7%) kur krahasohen vala 2 dhe vala 1.

Rritja e kostove gjithashtu paraqiti një sfidë për 27% të bizneseve, ndërsa në maj të vitit 2020 kjo çështje ishte sfiduese vetëm për 6%. Mund të vërehet gjithashtu një rritje e lehtë e ndërmarrjeve të cilat u përballën me vështirësi në qasjen në financave ose që përjetuan rënie të prodhimit (përkatësisht rritje me 6pp dhe 9pp). Sfidat e ndërlidhura me kostot kanë të bëjnë me masat e vendosura pasi që shumë nga aktivitetet e ndërmarrjeve ishin të kufizuara dhe duhej futur mjete të reja për të bërë biznes, të cilat ndërmorën më shumë investime me më pak likuiditet dhe qasje në financa.


Figura 127. Problemet për bizneset duke pasur parasysh situatën aktuale me COVID-19, vala 1 vs. vala 2





Bizneset të cilat nuk e ndaluan plotësisht veprimtarinë e tyre u pyetën më tej në lidhje me shqetësimet kryesore nëse situata COVID-19 vazhdon të përhapet gjatë dy-tre muajve të ardhshëm. Ndërsa problemet e situatës aktuale (siç diskutohet në detaje në grafikun e mësipërm) janë të ndryshme, shqetësimi kryesor i bizneseve lidhet me mungesën e klientëve nëse situata COVID-19 vazhdon për dy ose tre muaj të tjerë (65%).

Figura 128. Problemet e tanishme vs. shqetësimi kryesor nëse COVID-19 vazhdon të përhapet gjatë dy-tre muajve të ardhshëm, vala 1 vs vala 2



Rezultatet e anketës zbuluan më tej se fuqia punëtore e ndërmarrjeve është ndikuar nga pandemia COVID-19 dhe pasojat rrjedhëse në mënyrë të konsiderueshme. Mesatarisht (mesatarja e shkurtuar), ndërmarrjet mikro ulën numrin e tyre të punonjësve me orar të plotë me 0.7, ndërmarrjet e vogla me 2.9 dhe ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha me 12.4. Punësimi me gjysëm orar është prekur vetëm për ndërmarrjet e vogla. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se ndërmarrjet e Kosovës kanë reduktuar personelin me orar të plotë për 3.5 punonjës dhe personelin e tyre me gjysëm orar për 2.8 punonjës. Ju lutemi vini re se rezultatet e përgjithshme nuk janë mesatarja e thjeshtë e tri kategorive të ndërmarrjeve, por mesatarja e ponderuar.


Tabela 7 Numri i stafit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme para dhe pas COVID-19, mesatarja (mesatarja e shkurtuar)

Lloji i kontratës	Madhësia e ndërmarrjes	Para COVID-19	Pas COVID-19	Ndryshimi në numra	Ndryshimi në përqindje
Personel me orar të plotë	Mikro (1-9 punonjës)	3.1	2.4	-0.7	-23%
	Të vogla (10-49 punonjës)	20.1	17.2	-2.9	-14%
	Mesatare dhe të mëdha (50+ punonjës)	132.9	120.5	-12.4	-9%
	Total (të peshuara)	3.5	0.1		
Personel me gjysëm orar	Mikro (1-9 punonjës)	0.0	0.0	0.0	0%
	Të vogla (10-49 punonjës)	1.2	1.1	-0.2	-8%
	Mesatare dhe të mëdha (50+ punonjës)	8.9	8.9	0.0	0%
	Total (të peshuara)	2.8	0.0		

Më pas, bizneset u pyetën se çfarë lloj masash kanë ndërmarrë në mënyrë që të shmangin përhapjen e COVID-19 në vendin e punës ose për të përballuar situatën e përgjithshme.


Ngjashëm me rezultatet e të dhënave nga vala 1, shumica e punëdhënësve kanë pajisur stafin me doreza, maska dhe dezinfektues (90%). Më shumë punëdhënës kanë paguar paga minimale/më të ulëta (19%) sesa në maj të vitit 2020 (6%). Përdorimi i pushimit vjetor dhe sigurimi i transportit nga shtëpia në punë janë rritur gjithashtu përkatësisht me 6pp dhe 5pp. Më pak punëdhënës lejuan punë në distancë në nëntor 2020 (6%) krahasuar me majin 2020 (15%).

Figura 129. Masat e ndërmarra nga ndërmarrjet për punonjësit, vala 1 vs. vala 2




Të dhënat e ndara sipas madhësisë së ndërmarrjes treguan se ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha janë drejtuar më shpesh në përdorimin e pushimeve vjetore (46%) sesa ndërmarrjet e vogla (42%) ose mikro (10%). Më shumë nga ndërmarrjet e vogla zgjodhën të paguajnë pagë minimale/më të ulët (32%) sesa ndërmarrjet mikro ose të mesme dhe të mëdha (18% secila).

Figura 130 Masat e ndërmarra nga ndërmarrjet për punonjësit, sipas madhësisë së ndërmarrjes




Ndërmarrjet të cilat janë ende funksionale (ose pjesërisht funksionale) u pyetën më tej nëse të ardhurat, shpenzimet, shitjet dhe inventari i tyre janë ulur, rritur apo kanë mbetur të njëjtë që nga përhapja e COVID-19. Më shumë se tetë në 10 ndërmarrje raportuan rënie në shitjet e produkteve ose shërbimeve, si dhe në të ardhura (88% secila). Shpenzimet dhe kostot e punës dhe në anën tjetër janë rritur për një numër të konsiderueshëm të bizneseve (përkatësisht 44% dhe 19%).

Figura 131. Ndikimet në të ardhura, shpenzime, shitje dhe inventar



Ndërmarrjet mikro pësuan uljen më të madhe të shitjeve të produkteve ose shërbimeve, përcjellë nga ndërmarrjet e vogla dhe në fund nga ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Ulja e të ardhurave nga bizneset ndjehet kryesisht nga ndërmarrjet mikro, pastaj ndërmarrjet e vogla dhe të mesme e të mëdha. Ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha kanë përjetuar rritjen më të madhe në shpenzimet e përgjithshme dhe kostot e prokurimit, ndërsa ndërmarrjet e vogla rritjen më të madhe të kostove për qira, ujë, energji elektrike dhe pagesa të taksave krahasuar me ndërmarrjet e madhësive të tjera.


Figura 132 Ndikimet në të ardhura, shpenzime, shitje dhe inventar, sipas madhësisë së ndërmarrjes



Bazuar në aktivitetin e biznesit, hotelet, restorantet, kafenetë (HoReCa) kanë përjetuar uljen më të madhe të shitjeve të produkteve ose shërbimeve, pasuar nga prodhimi, ndërtimtaria dhe në fund tregtia. Këto të dhëna pasqyrojnë masat kufizuese me ç'rast HoReCa janë goditur më së shumti duke mos qenë në gjendje të veprojnë për një kohë të gjatë, të veprojnë me kapacitet të reduktuar dhe për një kohë më të shkurtër. Kurse shitjet përmes internetit (online) janë rritur gjatë pandemisë gjë që e ka zbutur uljen e shitjeve totale të kompanive tregtare.


Aktivitetet e biznesit HoReCa dallohen si ato që kanë rritjen më të madhe në kostot e punës, si dhe kostot e qirasë, ujit, energjisë elektrike, duke lënë pas rritjet në ndërtimtari, prodhim dhe në fund në tregti.

Figura 133 Ndikimet në të ardhura, shpenzime, shitje dhe inventar, sipas aktivitetit të biznesit



Tregtia elektronike (E-tregtia) u bë mjaft e përhapur pas pandemisë COVID-19. Rezultatet e anketës tregojnë se në përgjithësi, 4% e bizneseve filluan të përdorin tregtinë elektronike pas shpërthimit të ri të koronavirusit. Prej tyre, 14% ndërmarrje të reja të mesme dhe të mëdha, 14% ndërmarrje të vogla dhe 3% të ndërmarrjeve mikro.


Figura 134 Ndërmarrjet që përdorin tregtinë elektronike (e-tregtinë)



Më shumë se dy në tre të anketuar deklaruan se biznesi i tyre nuk po mendonte të merrte një kredi për të përballuar efektet e COVID-19 (76%). Kjo paraqet një rritje të lehtë të bizneseve që planifikonin të merrnin një kredi krahasuar me rezultatet e valës 1 (4pp).


Sidoqoftë, duhet theksuar që gati një në tre të anketuar që i përkasin një biznesi të mesëm ose të madh deklaruan se kompania e tyre po mendonte të merrte një kredi (31%). Gatishmëria për të marrë një kredi në përgjithësi zvogëlohet me madhësinë e kompanisë.

Figura 135. Konsiderimi i ndërmarrjeve për të marrë një kredi për t'u përballur me efektet aktuale të situatës COVID-19, vala 1 vs. vala 2 dhe sipas madhësisë së ndërmarrjes




Ndërmarrjet që deklaruan se nuk e konsideronin marrjen e një kredie, u pyetën për arsyet përkatëse. Pamundësia për të marrë një kredi për shkak të rrezikut të lartë të pamundësisë për ta paguar atë, u dallua gjatë valës 2 si arsyeja kryesore e përmendur nga 46% e të anketuarve. Vetëm 19% deklaruan të njëjtën gjë në maj 2020. Ndërsa 38% përmendën normën e pafavorshme të interesit në maj 2020 si arsyen kryesore, në nëntor 2020 pak më pak e bënë këtë gjithashtu (32%). Rreth 18% nuk shprehën nevojë për kredi, krahasuar me 22% të cilët deklaruan të njëjtën gjë gjatë valës 1. Duhet theksuar gjithashtu se pjesa e të anketuarve që deklaruan se ndërmarrja e tyre nuk ka nevojë për kredi pasi situata aktuale nuk pritet se do zgjasë, ka rënë nga 18% në 4%.

Figura 136. Arsyeja kryesore e mos konsiderimit të marrjes së një kredie, vala 1 vs vala 2



Pamundësia për të marrë një kredi për shkak të rrezikut të lartë të pamundësisë për ta paguar atë u përmend më shpesh nga ndërmarrjet mikro (47%) dhe të vogla (32%) sesa nga ato të mesme dhe të mëdha (20%). Pothuajse gjysma e ndërmarrjeve jashtë rajonit të Prishtinës nuk e konsideruan marrjen e një kredie për shkak të pamundësisë për ta paguar atë (49%), krahasuar me vetëm 22% të cilat ishin të vendosura brenda rajonit të kryeqytetit.

Figura 137. Arsyeja kryesore e mos konsiderimit të marrjes së një kredie, sipas madhësisë së ndërmarrjes






### 3.2.3 Pritjet për të ardhmen

Kjo pjesë përfshin pyetje, ndër të tjera, në lidhje me të ardhmen e bizneseve gjatë pandemisë së vazhdueshme, si dhe sugjerime se si bizneset mund të përkrahen më mirë gjatë situatës aktuale.

Duke theksuar pasigurinë e përgjithshme që është e pranishme në tërë botën, më shumë se një e treta e ndërmarrjeve nuk dinin një përgjigje kur u pyetën se edhe sa gjatë biznesi i tyre mund të përballojë situatën pandemike (36%). Gjatë valës 1, kjo përqindje ishte vetëm 13%.


Pothuajse po aq parashikuan se biznesi i tyre mund të përballonte situatën për 1-2 muaj më shumë (35%) një rritje prej 10pp krahasuar me rezultatet e valës së parë. Në maj 2020, dukshëm më shumë thanë se ata parashikojnë që biznesi i tyre mund të përballon për të paktën 3-6 muaj më shumë se në nëntor 2020 kur vetëm 8% deklaruan të njëjtën gjë. Megjithatë, duhet të theksohet se 19% menduan se biznesi i tyre mund të përballojë situatën për më shumë se 6 muaj (19%), një rritje prej 9pp.

Figura 138. Duke marrë parasysh të gjitha, edhe për sa kohë mund të përballojnë bizneset situatën aktuale, vala 1 vs vala 2




Kur ju kërkua të japin sugjerime për institucionet e Kosovës mbi masat që mund të ndihmojnë bizneset e të anketuarve, rreth gjysma përmendën miratimin e ligjit për rimëkëmbje ekonomike (51%). Një tjetër 15% sugjeroi që kufizimet në lëvizjen e njerëzve dhe funksionimin e bizneseve duhet të lehtësohen, ndërsa nga 7% secili përmendën lirimet nga tatimet dhe taksat komunale dhe dhënien e kredive me interes të ulët. Në përgjithësi, 15% nuk kishin sugjerime.

Figura 139. Sugjerime për institucionet e Kosovës mbi masat që mund të ndihmojnë bizneset për t'u përballur me situatën




Gati gjysma nuk kishin ndonjë sugjerim për organizatat ndërkombëtare mbi masat që mund të ndihmonin bizneset e tyre (44%). Sidoqoftë, një në tre të anketuar të biznesit sugjeruan që mbështetja financiare përmes pakove ekonomike do të ndihmonte (33%). Ky sugjerim është shprehur më së shpeshti nga të anketuarit në ndërmarrjet mikro (34%) krahasuar me ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha (26%) dhe ndërmarrjet e vogla (17%). Të anketuarit që i përkisnin ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha si dhe atyre të vogla kishin më shumë gjasa të sugjeronin transparencën në ndarjen e granteve dhe mbështetjen financiare si një masë e dobishme (përkatesisht 24% dhe 23%).

Figura 140. Sugjerime për organizatat ndërkombëtare mbi masat që mund të ndihmojnë bizneset për t'u përballur me situatën, sipas madhësisë së ndërmarrjes




Rreth 43% e të gjitha ndërmarrjeve që morën pjesë në këtë studim deklaruan se kishin pasur plane për investime para pandemisë COVID-19. Ndërmarrjet më të reja me vite në treg prej një deri në pesë vjet (54%) si dhe kompanitë e vogla, të mesme dhe të mëdha (49% secila) më shpesh kishin planifikuar investime para se të shfaqej COVID-19.

Figura 141. Bizneset që kishin plane investimi para situatës COVID-19, sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe viteve në treg




Ndërmarrjet që kishin planifikuar të bënin investime para situatës COVID-19, u pyetën më pas nëse këto plane kanë ndryshuar dhe më shumë se tre në katër të anketuar thanë se kishin vendosur të përmbaheshin nga bërja e ndonjë investimi (79%). Gjithsesi, kjo përshkruan një rënie të vogël krahasuar me valën 1, ku 84% kishin deklaruar të njëjtën gjë. Pak më shumë thanë se ata po planifikonin më pak investime (16%) ose se po planifikonin të rrisnin investimet (3%) krahasuar me valën 1.

Figura 142. Ndryshimi i planeve për të investuar për shkak të COVID-19, vala 1 vs. vala 2



Ngjashëm me valën e fundit të vlerësimit, shumica dërrmuese e ndërmarrjeve të anketuara nuk panë mundësi të reja biznesi në lidhje me COVID-19 (89%). Sidoqoftë, të dhënat zbuluan një rritje të lehtë të bizneseve të cilat panë mundësi të reja në lidhje me shfaqjen e COVID-19 (11%). Kjo paraqet një rritje prej 7pp.


Figura 143. Bizneset që gjetën mundësi të reja në lidhje me COVID-19, vala 1 vs. vala 2



Në fund, bizneset u pyetën për vlerësimin e tyre se kur mendojnë se Kosova do të kthehet në "jetën normale" si para pandemisë. Në nëntor 2020, dy në pesë të anketuar të ndërmarrjeve besuan se do të duhen më shumë se gjashtë muaj derisa Kosova të kthehet në jetën normale (40%), kjo paraqet një rritje prej 13 pikë përqindjeje krahasuar me majin 2020.

Për më tepër, në krahasim me rezultatet e të dhënave nga maji 2020 (15%), mbi dy herë më shumë (31%) gjithashtu besuan se mund të duhen tre deri në gjashtë muaj derisa situata të normalizohet përsëri.


Figura 144. Perceptimi i bizneseve se kur Kosova do të kthehet në jetën normale, vala 1 vs. vala 2



Pothuajse një në tre ndërmarrje në pronësi të grave (30%) dhe 26% të ndërmarrjeve me disa pronarë perceptojnë se Kosova do të kthehet në jetën normale pas më shumë se gjashtë muaj, ndërsa 18% e bizneseve

në pronësi të burrave mendojnë të njëjtën gjë. Pjesë të ngjashme të secilit grup, që i bie të ndërmarrjeve në pronësi grave (34%), burrave (34%), dhe disa pronarëve (35%) mendojnë se Kosova do të kthehet në jetën normale brenda 3-6 muajsh. Më shumë ndërmarrje në pronësi të burrave mendojnë se Kosova do të kthehet në normalitet për 1-2 muaj (24%) sesa të atyre në pronësi të grave (14%) dhe me disa pronarë (11%). Pjesë më të vogla të të gjitha ndërmarrjeve mendojnë se gjërat do të kthehen në normalitet për më pak se një muaj.

Figura 145 Perceptimi i bizneseve se kur Kosova do të kthehet në jetën normale, sipas gjinisë së pronarëve të kompanisë



# 4. Përfundime

## 4.1. Përfundime

Ky raport kishte për qëllim të eksplorojë ndikimin e pandemisë COVID-19 në shëndetin, mirëqenien financiare dhe psikologjike të njerëzve në Kosovë, si dhe ndikimin në performancën ekonomike të sektorit privat dhe implikimet e lidhura për bizneset në tërë Kosovën. Raporti gjithashtu vlerësoi ndryshimet në rezultatet e të dhënave me kalimin e kohës, duke krahasuar gjetjet e valës së parë të SEIA të kryer në maj 2020, me gjetjet e valës së dytë të përfunduar në nëntor 2020.

### PËRFUNDIMET E ANKETËS ME EKONOMI FAMILJARE

Implikimet e pandemisë COVID-19 në familjet në Kosovë u bënë veçanërisht të dukshme kur u analizuan të dhënat mbi dinamikat shoqërore dhe efektet në shëndetin psikologjik dhe mendor të të anketuarve në nëntor 2020.

Krahasuar me gjetjet e të dhënave nga maji 2020, pjesa e të anketuarve që deklaruan se kishin pasur efekte në shëndetin e tyre psikologjik, emocional dhe mendor është rritur ndjeshëm (nga 28% në 36%). Një rritje e kohës kushtuar mbështetjes emocionale të anëtarëve të tjerë të rritur të familjes thekson më tej ashpërsinë e ndikimit psikologjik që rezulton nga pandemia. Të dhënat gjithashtu sugjerojnë që përparimi në zvogëlimin e hendekut gjinor mund të ketë ngecur - ose të ketë pasur regres - me rritjen e orëve në punët e shtëpisë të kryera nga gratë sikurse pastrimi dhe gatimi që mbetën të larta, kurse, në të njëjtën kohë, rritja në mbështetje nga partnerët u deklarua vetëm me 36% të grave. Për më tepër, gjetjet nga nëntori 2020 sugjerojnë që dhuna në familje vazhdon të jetë në rritje në Kosovë. Gati dy të tretat e të gjitha grave perceptuan një rritje të këtij fenomeni, një perceptim i cili është dëshmuar edhe nga statistikat zyrtare të policisë që treguan një rritje të rasteve të raportuara në Kosovë gjatë pandemisë.

Implikimet financiare, që burojnë nga pandemia e COVID-19, në familjet në Kosovë vazhduan të jenë shqetësuese. Më shumë të anketuar deklaruan se kanë humbur vendet e tyre të punës në nëntor 2020 (11%) krahasuar me majin 2020 (8%). Shumica e atyre që kishin humbur vendin e punës nuk morën ndihmë financiare ose përfitime nga papunësia. Mbështetja në të mira materiale për familjet mbeti pothuajse inekzistente. Përdorimi i kursimeve dhe shpenzimi i më pak burimeve financiare për kohën e lirë dhe mallrat jo-thelbësore është i dukshëm në shumicën e familjeve, duke përkeqësuar më tej cilësinë e jetës së njerëzve në Kosovë. Një numër i konsiderueshëm i familjeve gjithashtu raportuan shpenzime të reduktuara për shëndetësinë (17%) dhe arsimin (23%).

Të rriturit e punësuar në Kosovë më së shpeshti kryenin punën e tyre në ambientet e punës, ndërsa gjithashtu shumica e fëmijëve ndoqën shkollën personalisht në nëntor 2020. Vetëm 3% e të punësuarve punonin në distancë me orar të plotë, ndërsa preferenca për të vazhduar punën në distancë qëndronte me vetëm 31%. Pak fëmijë ndoqën mësimin në distancë; shumica dërrmuese ishte në gjendje të merrte pjesë në mësimin fizik rregullisht.

Ndërsa qasja në shërbimet themelore paraqiste vështirësi për shumë familje në maj 2020, që nga nëntori i vitit 2020, dukshëm më pak raportuan probleme në këtë drejtim. Lehtësimi i masave kufizuese gjatë gjithë verës së vitit 2020 mund të ketë mundësuar qasjen më të lehtë. Megjithatë, fakti që rreth 25% e të anketuarve raportuan vështirësi në qasjen në ushqim, pajisje mbrojtëse personale dhe shërbime shëndetësore që nga nëntori i vitit 2020 kërkon vëmendje.

Me botën duke shpejtuar për të filluar fushata vaksinimi për COVID-19 në masë të madhe, në valën e dytë të SEIA gjithashtu u vlerësua nëse të anketuarit do të ishin të gatshëm të vaksinoheshin kur vaksinat të jenë në dispozicion. Të dhënat zbuluan një 44% tronditës të të gjithë të anketuarve që shprehën mosgatishmëri për të marrë pjesë në proceset e vaksinimit.



## PËRFUNDIMET E ANKETËS ME NDËRMARRJE

Efektet negative të vazhdueshme të pandemisë COVID-19 mbi ndërmarrjet në Kosovë ishin të dukshme kur u analizuan rezultatet e të dhënave të marra nga vala e dytë e SEIA-s.

Kritja e përgjithshme e ndërmarrjeve të cilat raportuan efekte negative ose shumë negative për shkak të pandemisë ra në sy. Mbi gjysma e të gjitha ndërmarrjeve vlerësuan se efektet në bizneset e tyre ishin shumë negative (55%), në krahasim me vetëm 23% në maj 2020. Tri problemet kryesore që kanë të bëjnë me situatën aktuale ishin mungesa e klientëve, vështirësitë në pagimin e pagave dhe në përmbushjen e detyrimeve tatimore.

Shumë më pak biznese raportuan një ndalje të plotë në aktivitetet gjatë valës së dytë të SEIA-s. Ata që ndaluan plotësisht funksionimin e tyre më së shpeshti përmendnin mungesën e klientëve si arsye kryesore, ndërsa në maj të vitit 2020 masat kufizuese ishin arsyeja kryesore. Përkundër lehtësimit të masave kufizuese në Kosovë, kundërshtimi i përgjithshëm ndaj masave kufizuese u rrit në mënyrë drastike midis dy anketave. Përdërisa 27% e ndërmarrjeve kundërshtuan masat kufizuese deri në një masë në maj të vitit 2020, gjatë valës së dytë 58% e tyre shprehën kundërshtim.

Rënia e shitjeve të produkteve ose shërbimeve, si dhe e të ardhurave, përbënin një sfidë të madhe për shumicën e ndërmarrjeve në nëntor 2020, ndërsa njëkohësisht përjetuan edhe rritje të kostove dhe shpenzimeve. Ngjashëm me gjetjet nga maji i vitit 2020, shumica e ndërmarrjeve që kishin planifikuar investime para shpërthimit të COVID-19 vendosën të mos i ndërmarrin ato. Një numër më i madh i ndërmarrjeve nuk ishin të sigurt se edhe sa gjatë mund të përballen me situatën aktuale. Kishte një rritje të atyre të anketuarve që besuan se do të duhen më shumë se gjashtë muaj derisa Kosova të jetë në gjendje të kthehet në jetën normale.

Miratimi i Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike u dallua si masa kryesore që do të ndihmonte ndërmarrjet në Kosovë. Mbështetja financiare përmes pakove ekonomike nga organizatat ndërkombëtare u përmend gjithashtu si një masë e cila mund të lehtësonte ndërmarrjet e trazuar në Kosovë.

Pas disa përpjekjeve të dështuara, Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike u miratua në Dhjetor 2020. Vala e tretë e SEIA, e planifikuar për TM1 në 2021, mund të zbulojë nëse masat e lehtësimit ekonomik do të kenë prodhuar efekte pozitive deri atëherë në bizneset në Kosovë.